



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 56/2019 (JR)
Datë 07.11.2019

Nr. 25 i vendimit
Datë 29.07.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ardian Hajdari	Gjyqtar
Natasha Mulaj	Gjyqtare
Sokol Çomo	Gjyqtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 29.07.2021, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ardian Ylli, prokuror/drejtues i komanduar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 182, datë 18.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 7, 13, 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, nëpërmjet të cilave ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrën e prokurorit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ardian Ylli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit/drejtuesit të komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, iu nënshtrua rivlerësimit *ex officio* me shortin e hedhur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më datë 15.03.2018.

2. Mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se:

- i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, pasi ka kryer verifikimin e deklaramëve në formularin e kontrollit të figurës dhe të dhënave të tjera, bazuar në përcaktimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin², duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

2.3. Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka dërguar raportin³ mbi vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe pesë dokumentet e tjera të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhëna nga burimet arkivore.

II. Vendimi i Komisionit

3. Pasi kreu hetim për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë dy kredite e marra pranë Fondit Besa, përkatësisht prej 200.000 lekësh dhe 300.000 lekësh në vitet 2004 dhe 2009, sikurse nuk ka deklaruar as gjendjen e këtyre kredive ndër vite, apo shlyerjen e plotë të tyre, respektivisht në vitet 2005 dhe 2012. Për rrjedhojë, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm. Lidhur me analizën financiare të kryer për periudhën 2003 – 2016, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera nga ai dhe personat e lidhur, duke rezultuar me një balancë financiare negative, përkatësisht në vitet 2004, 2006, 2008, 2010-2015, në totalin prej 4.197.149 lekësh.

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.01.2018, për dërgimin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 15.5.2019.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 14.09.2018.

Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera prej tij dhe prej personave të lidhur, ndër vite.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit u gjet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Sipas Komisionit, subjekti ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, nuk u provua të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo se mund të vihet nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”; sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka nivelin kualifikues.

4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 182, datë 18.07.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi konkludoi se ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, bazuar në nenet 4, pika 2, 58, pika 1, germa “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Ankimi i subjektit të rivlerësimit mbështetet në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 6, 7, 13, 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), në nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “K.Pr.Administrative”) dhe në nenin 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Ankimi ka për objekt ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
6. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim shkaqe që lidhen me vlerësimin e provave të paraqitura dhe të administruara për kontrollin e kriterit të pasurisë, si dhe shkaqe që lidhen me shkelje procedurale. Subjekti po ashtu pretendon se vendimi është pasojë e një vlerësimi të padrejtë të provave të paraqitura prej tij, e një interpretimi të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe të Aneksit të Kushtetutës, dhe e një procesi të parregullt ligjor për shkak të mosrespektimit të të drejtave themelore të përcaktuara në Kushtetutë dhe KEDNJ.
7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi nuk mbështetet në prova dhe se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk janë vlerësuar fakte që rezultojnë nga provat dhe deklaramet e tij gjatë procesit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka detajuar pretendimet e tij mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni për secilin vit, duke dhënë argumentet për ndreqjen/“korrigjimin” e vlerave në zëra specifikë. Në përfundim, pasi ka argumentuar për balanca pozitive, subjekti ka parashtruar se të ardhurat e realizuara nga ai dhe familjarët e tij mbulojnë të gjitha shpenzimet familjare. Gjatë hetimit administrativ, ka paraqitur provat që mbështesin pretendimet e tij, të cilat janë pasqyruar edhe në aktin e ekspertimit të shoqërisë audituese ndërkombëtare “{***}”. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

7.1. Komisioni nuk ka vlerësuar drejt të ardhurat, pasi nuk janë përfshirë në shumën e të ardhurave 300.000 lekë kursime të babait nga pensioni në vitet 1982-2002, si dhe 750.000 lekë të përfituara në vitin 2012 pas ceremonisë mortore të babait, të përdorura nga familja atë vit dhe vitin pasardhës, përkatësisht në vlerat 500.000 dhe 240.000 lekë. Kursimet nga pensioni janë përdorur sipas nevojave familjare në kohë dhe Komisioni nuk ka provë që të zhbëjë

deklarimet e tij për mënyrën e përdorimit, duke përdorur dy standarde në konsiderimin e shpjegimeve të dhëna prej tij.

7.2. Komisioni duhet të kishte saktësuar përdorimin e kredive që janë përdorur për mbulimin e nevojave financiare të familjes sikurse edhe të biznesit, dhe në ndonjë rast janë përdorur në vitin pasardhës. Në këtë drejtim, subjekti kërkon që në analizën financiare:

- Nga fondet e kredisë së vitit 2007, në vlerën prej 15.000 euro [pranë NGB Bank], fondet e marra hua gjatë vitit 2007 të pakësohen, ndërsa fondet e përdorura gjatë vitit 2008 të shtohen si të ardhura në vlerën 450.000 lekë.
- Nga fondet e dy kredive të vitit 2009, në vlerat në total prej 800.000 lekësh, fondet e marra hua gjatë vitit 2009 të pakësohen, ndërsa fondet e përdorura gjatë vitit 2010 të shtohen në vlerën 500.000 lekë.

7.3. Komisioni nuk ka vlerësuar saktë shpenzimet familjare sikurse:

- shpërndarjen e shpenzimeve për arredim në kohë;
- shpenzimet që i përkasin aktivitetit privat të bashkëshortes përkundër dy kredive të marra për këtë qëllim në vitet 2006 dhe 2007. Analiza financiare si rrjedhojë, është rënduar dy herë, pasi janë llogaritur në shpenzime këstet e kredive dhe shpenzimet për aktivitetet, sipas kontratave të kredisë;
- shpenzimet për shkollimin e fëmijëve në vitet 2009 dhe 2014. Konkretisht, për vitin 2009 duhet të ishte përlllogaritur pagesa prej 1.000 eurosh [ose 137.170 lekësh], ndërsa në vitin 2014, shuma e paguar ka qenë 1.500 euro ose 210.165 lekë dhe jo 288.187 lekë;
- shpenzimet për udhëtime jashtë vendit janë përlllogaritur më tepër. Kostot e udhëtimit, akomodimit dhe të qëndrimit kanë qenë më të ulëta dhe një pjesë e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga bashkëshortja janë për qëllim biznesi dhe blerje të lidhura me to, e si rrjedhojë kanë qenë përlllogaritur në bilancet e biznesit të saj.

7.4. Bazuar në deklaratat periodike të pasurisë, në shpjegimet dhe provat e paraqitura gjatë procesit, përfshirë edhe aktin e ekspertimit kontabël, Komisioni do të vërtetonte se të ardhurat e tij dhe familjes ndër vite mbulojnë të gjitha shpenzimet familjare dhe rezultojnë me një vlerë pozitive në shumën 2.199.940 lekë.

7.5. Pasaktësitë apo “harresat e vogla” në deklaratat e interesave periodikë privatë rrjedhin nga mungesa e eksperiencës së nevojshme financiare për plotësimin e formularëve, por nuk përbëjnë përpjekje për të fshehur pasuri apo mungesë të burimeve financiare. Pasaktësitë nuk sanksionohen nga neni 21 i ligjit nr. 9049/2003 dhe nuk cenojnë situatën e përgjithshme financiare. Ato janë rezultat i rregullave jorigoroze të aplikuara nga organet e kontrollit të pasurisë gjatë kontrolleve periodike, e që duhen vlerësuar në kontekst të situatës ekonomike dhe shoqërore që ka kaluar shoqëria ku edhe subjektet e rivlerësimit bëjnë pjesë. Ndërgjegjësimi në mbajtjen e të dhënave për shpenzimet ka qenë i vështirë në kushtet e informalitetit të zgjatur. Kërkesat e ligjit për deklarimin e pasurisë kanë qenë minimale e janë shtuar e specifikuar në vijim.

7.6. Komisioni nuk arsyeton pse shpjegimet e dhëna prej tij nuk janë konsideruar të plota. Ato i referohen realitetit ekonomik dhe vërtetohen me nivelin e pasurisë familjare. Të ardhurat rrjedhin nga burime të ligjshme, lehtësisht të verifikueshme. Për përmbushjen e nevojave financiare, është marrë herë pas here kredi. Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve familjare është pozitiv.

7.7. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së dhe të ekspertit kontabël, çka minimalisht duhet të kishte bërë të nevojshme çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe kryerjen e një ekspertimi të pavarur.

7.8. Subjekti dhe bashkëshortja disponojnë vetëm një pasuri të paluajtshme, të krijuar nga familja e origjinës. Gjatë hetimit administrativ, nuk është konstatuar asnjë problem lidhur me kontrollin e figurës dhe me kontrollin e aftësive profesionale. Nuk rezultojnë akte, sjellje apo veprime të tij, që të kenë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

7.9. Subjekti ka kryer deklaram të plotë të të gjitha pasurive të familjes në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë ndër vite. Pasuritë e krijuara nga familja justifikohen plotësisht me burime të ligjshme të ardhurash. Përlllogaritjet e Komisionit për shpenzimet janë të pasakta, rrjedhin nga skema të paaplikuara më parë, si ato të udhëtimeve, e për rrjedhojë balancat negative duhen konsideruar nga Kolegji me proporcionalitet dhe objektivitet.

8. Subjekti i rivlerësimit parashtron se vlerësimi që ai nuk ka rritur nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë është i pambështetur në prova dhe në Kushtetutë e në ligj. Në mënyrë të përmbledhur, pretendimet në lidhje me interpretimin e ligjit janë si vijon:
- Shkarkimi është bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për deklaram të pamjaftueshëm, pavarësisht se Komisioni shprehet për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 4.197.149 lekë, shkak që lidhet me nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Ky përbën një interpretim të shtrirë në dëm, dhe më të ashpër për subjektin. Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 duhet të interpretohet në përputhje me parashikimet e nenit D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke shmangur dhënien e kuptimeve më të gjera nga sa ato pasqyrojnë.
 - Asnjë sanksion nuk mund të zbatohet ndaj subjektit të rivlerësimit nëse organet verifikuese nuk gjejnë se ai ka paraqitur të dhëna të rreme me qëllim fshehjen e pasurisë.
 - Vendimi është i padrejtë, i paracaktuar dhe jologjik. Komisioni nga njëra anë shprehet se shtesat dhe likuidimet në vite janë të sakta, dhe nga ana tjetër, pasi analizohet përputhshmëria e tyre me deklaratën *vetting*, tabela paraqet diferenca.
 - Vetëm mosdeklarimi i dy kredive të marra në vitet 2004 dhe 2009 nuk mund të konsiderohet deklaram i pamjaftueshëm. Nuk ka qenë qëllim fshehja e tyre. Ato rrjedhin nga burim i ligjshëm, në vlera të vogla (200.000 lekë dhe 300.000 lekë), dhe janë lehtësisht të verifikueshme.
 - Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, aplikohet në mënyrë kumulative dhe kur deklarami për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë është i pamjaftueshëm, pasi pasuria mund të jetë rezultat i abuzimit me detyrën.
 - Shkaku i vetëm mbi bazën e të cilit mund të zbatohet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është ajo që lidhet me dyfishin e pasurisë [parashikuar në nenin 61, pika 1]. Në rastin konkret, edhe nëse merret e mirëqenë, diferenca negative që ka rezultuar nga analiza e Komisionit është larg dyfishit të pasurisë së ligjshme, pasi vlera e deklaruar nga Komisioni përbën afërsisht 8% të të ardhurave në total.
9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i gabuar, në kundërshtim me të drejtën materiale dhe procedurale, dhe në kundërshtim me të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja. Komisioni e ka kryer procesin e hetimit administrativ në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve dhe të gjykimit në seancë publike dhe në shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi është hetuar dhe vlerësuar nga të njëjtët anëtarë. Për rrjedhojë, ai nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj si e tillë. Subjekti argumenton në mënyrë të përmbledhur se:
- Komisioni i ka njoftuar rezultatet e analizës financiare pasi është marrë vendimi për përfundimin e procesit të hetimit administrativ; nuk janë vlerësuar si provë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së dhe as akti i ekspertimit kontabël i paraqitur nga subjekti.
 - Seanca dëgjimore ishte fiktive. Ai [subjekti] nuk pati mundësi të kundërshtonte konstatimet e referuara meqenëse relatori sqaroi se provat do të vlerësoheshin nga Komisioni para

dhënies së vendimit. Komisioni nuk kishte shqyrtuar provat e paraqitura prej tij mbi rezultatet e hetimit e, për rrjedhojë, nuk ishte në gjendje të *debatonte* apo të kërkonte sqarime për to. Komisioni ka marrë përsipër të bëjë rolin e ekspertit dhe të japë gjykim mbi çështje jashtë veprimtarisë gjyqësore që kërkojnë njohuri të posaçme, çka provon paragjykimin e procesit. Vendimi është marrë vetëm mbi bazën e konkluzioneve të hetimit administrativ, pa u dhënë rëndësi provave të paraqitura nga subjekti. Vendimmarrjes i mungon objektiviteti dhe proporcionaliteti.

- Komisioni nuk e ka informuar subjektin për identitetin e këshilltarit ekonomik që ka kryer analizën financiare. Këshilltari ka rol ndihmës për trupin gjykues dhe nuk mund të ngarkohet me rolin e ekspertit, i cili ka njohuri të posaçme dhe i përzgjedhur gjatë gjykimit për dhënien e përgjigjeve për çështjet për të cilat ai ka njohuri. Rezultatet e analizës financiare të kryer nga këshilltari ekonomik janë të pasakta, vërtetuar edhe nga korrigjimet që Komisioni ka bërë në vendimin përfundimtar.
- Subjekti nuk kishte mundësi të kundërshtonte rezultatet e analizës financiare pasi Komisioni ka pasqyruar në raport dhe vendim vetëm përfundimin dhe jo provën – aktin e ekspertimit tekniko-financiar të kryer nga këshilltari.
- Komisioni nuk ka pasur tagër t'i jepte vlerë të paracaktuar asnjë prove dhe mbivlerësimi i konkluzioneve teknike të këshilltarit ekonomik është në shkelje flagrante të kuadrit ligjor për çmuarjen e provave, mbështetur edhe në vendimin nr. 12/2003 të Gjykatës Kushtetuese.
- Trupi gjykues që ka kryer hetimin, ka dhënë edhe vendimin përfundimtar, gjë që përbën konflikt të hapur interesi dhe është në kundërshtim me parimet e kontradiktorialitetit, gjykimin të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë. Është cenuar e drejta për një proces të parregullt ligjor pasi nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj si e tillë, sipas përcaktimeve të nenit 6/1 të KEDNj-së dhe praktikës së konsoliduar të GjEDNj-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese [vendimi nr. 34/2015] për respektimin e parimit të barazisë së armëve nga ana e gjyqtarit.
- Qëndrimi është i njëanshëm, i pabarabartë dhe diskriminues. Në raste të ngjashme, Komisioni nuk i ka konsideruar diferencat financiare si të mjaftueshme.

10. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon riçeljen e hetimit gjyqësor, marrjen e provave të reja dhe rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, bazuar në nenet 49 dhe 51, germa “c” e ligjit nr. 49/2012. Në kushtet kur komisionerët janë hetues, vlerësues dhe vendimmarrës, gjykimi i çështjes nga Kolegji, në shkallë të dytë, duhet të bëhet në seancë gjyqësore publike, me qëllim vlerësimin dhe çmuarjen e plotë dhe të saktë të të gjitha provave të administruara nga Komisioni dhe të atyre të kërkuara prej tij, si dhe për t'i dhënë mundësi atij të dëgjohet nga një gjykatë, si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

11. Subjekti kërkon, bazuar në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 66, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së:

- i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative dhe çeljen e hetimit administrativ, analizimin dhe marrjen e provave të paraqitura prej tij, të cilat nuk janë analizuar prej Komisionit, deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ (seanca dëgjimore publike);
- ii) konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, ligjore dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj tij;
- iii) ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 182, datë 18.07.2019 dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe drejtues i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.⁴

12. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit: (i) aktin e ekspertimit kontabël të ekspertit T. Gj. që mban datën 04.07.2019, që sipas subjektit nuk është shqyrtuar nga Komisioni, pavarësisht se është administruar si provë; dhe (ii) tabelën e analizës financiare në mbështetje të argumenteve të ankimit.
13. Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime me shkrim⁵, të shoqëruara me dokumentacion provues⁶, në respektim të afatit pesëditor përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi. Në këto pretendime, subjekti argumenton në të njëjtën linjë me ankimin. Konkretisht, në parashtrime subjekti ka theksuar se:

13.1. Konkluzionet e Komisionit janë jologjike, pasi ndërsa nuk është gjetur asnjë pasaktësi në deklarimin e pasurive të tij në deklaratën *vetting*, e që janë realizuar me burime të ligjshme, është konkluduar për balancë negative në vlerën 4.197.149 lekë. E vetmja pasaktësi është ajo e mosdeklarimit të dy kredive të marra në deklaratat e interesave privatë periodikë, gjendjen e tyre ndër vite dhe mbylljen e tyre respektivisht në vitet 2005 dhe 2012, e cila nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës disiplinore, referuar edhe jurisprudencës së deritanishme.

13.2. Ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

- Meqenëse vendimi i dhënë nga Komisioni nuk është ankimuar nga Komisioneri Publik, bazuar në parimin *no reformatio in peius*, konkluzionet e nxjerra nga Komisioni për pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit, të krijuara me të ardhura të ligjshme, nuk mund të merren në analizë nga Kolegji.
- Logjikshëm, për të gjitha vitet kur janë blerë pasuritë e analizuar për të cilat nuk janë konstatuar probleme nga Komisioni, balanca duhet të vlerësohet nga Kolegji si pozitive. Të tillë janë vitet 2006 dhe 2014, në të cilët Komisioni merr në analizë blerjen e automjeteve dhe, në vlerësimin e tij, nuk konstatohen probleme, ndërkohë që e nxjerr bilancin vjetor në vlera negative; apo gjendja e *cash-it*, ku Komisioni konkludon se shtesat dhe pakësimet e likuiditeteve ndër vite janë të sakta dhe nga ana tjetër konstaton diferenca negative në vitet nga buron likuiditeti, *cash-i*.
- Në mbështetje të pretendimeve të tij, përkatësisht në lidhje me të ardhurat nga ceremonia mortore dhe në lidhje me përdorimin e fondeve të kredisë në vitet pasardhëse, subjekti referon pjesë nga arsyetimi i vendimit nr. 22/2019 i Kolegjit (paragrafi 19) dhe nga vendimi nr. 20/2019 i Kolegjit (paragrafi 67).
- Totali i kësteve të kredisë së paguar për vitin 2014 ka qenë 5.961.115 lekë, pra 168.000 lekë më pak se sa e ka përlllogaritur Komisioni, sikurse paraqitet në vërtetimin e datës 22.07.2021, të lëshuar nga ABI Bank.
- Një pjesë e shpenzimeve për arredim, në vlerën 90.000 lekë, duhet të përfshihen në vitin 2005 dhe jo në vitin 2004.

⁴ Në faqen 42 të ankimit, subjekti i rivlerësimit shprehet se për hartimin e ankimit është referuar: i) në të gjitha provat e paraqitura prej tij në Komision, të administruara në fashikujt e dosjes, por të pashqyrtuara nga Komisioni dhe për të cilat kërkon prej Kolegjit të çelë hetimin për shqyrtimin gjyqësor të tyre; ii) në vendimet e GjEDNj-së dhe opinionet ndërkombëtare të dhëna në funksion të procesit të rivlerësimit; iii) në opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së për çështien e subjektit të rivlerësimit, zni. Antoneta Sevdari.

⁵ Më datë 23.07.2021, në adresën elektronike të sekretarisë së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime dhe prova lidhur me ankimin e tij. Aktet janë përcjellë edhe me shërbim postar, në datën 23.07.2021.

⁶ Vërtetim nga ABI Bank me nr. {***} prot., datë 22.07.2021; nxjerrje llogari nga ABI Bank për periudhën janar 2011 – dhjetor 2014; mandat arkëtimi i datës 22.07.2021, lëshuar nga ABI Bank për lëshimin e vërtetimit të datës 22.07.2021; deklaratë noteriale nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 22.07.2021, të znj. M. Y. (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit).

- Komisioni i ka nisur në rezultatet e hetimit administrativ, një analizë financiare me bilanc negativ në vlerën 6.535.235 lekë, ndërkohë që i ka kaluar barrën e provës për vlerën negative 3.453.402 lekë, ndërsa në vendim ka vendosur vlerën 4.197.149 lekë.
- Vendimi është jologjik dhe i pavlefshëm, pasi ka mungesë të argumenteve ligjore dhe financiare, gjë që cenon legjitimitetin e vendimit gjyqësor dhe sigurinë juridike, sikurse është arsyetuar në vendimin në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.
- Në afërsisht 28 vite punë disponon pak pasuri: një banesë të privatizuar në vitin 1993 dhe një makinë, një aktivitet privat të bashkëshortes (biznes i vogël) dhe disa likuiditete. Është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale dhe i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, bazuar në raportin e DSIK-së.

133. Me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së të shprehur në vendimin Moiseyev kundër Rusisë, 09.10.2008 § 217, në parashtrime subjekti kërkon që, nëse Kolegji do të kryejë vetë analizën financiare, të mbahet në konsideratë parimi i proporcionalitetit, i zbatuar tashmë në jurisprudencën e Komisionit dhe Kolegjit, referuar arsyetimit të vendimeve nr. 31/2020 të Kolegjit dhe të vendimeve nr. 188/2019, nr. 152/2019, nr. 218/2019, nr. 176/2019, nr. 201/2019, nr. 281/2019, nr. 283/2019 të Komisionit.

IV. Vlerësimi i çështjes

A. *Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit*

14. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë subjekt rivlerësimi. Ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* pasi brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁷, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumentesh.
15. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”) mori fillimisht në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative dhe çeljen e hetimit administrativ, analizimin dhe marrjen e provave të paraqitura prej tij, të cilat nuk janë analizuar prej Komisionit, deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ. Subjekti kërkoi gjykimin në seancë gjyqësore publike nga Kolegji edhe në kuadër të gjykimit në shkallë të dytë të çështjes së tij, për t’i dhënë mundësi atij të dëgjohet nga një gjykatë. Kjo kërkesë është paraqitur edhe në parashtrimet e datës 23.07.2021 ku, ndër të tjera, subjekti ka kërkuar çeljen e hetimit administrativ me qëllim kryerjen e një analize të re financiare dhe kryerjen e debatit gjyqësor mbi këtë provë të rëndësishme për të. Në vijim të sa më sipër, pasi shqyrtoi procedurën e ndjekur në Komision për procesin e rivlerësimit të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton shkelje në kuptim të nenit 51, pika 1⁸ e ligjit nr. 49/2012, të cilat do të bënin të domosdoshëm zhvillimin e debatit

⁷ Vendimi i Komisionit nr. 182, datë 18.07.2019, i është njoftuar nëpërmjet shërbimit postar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 04.10.2019 (me shënimin e marrjes në dorëzim M. Y., më datë 05.10.2019). Ankimi është regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 18.10.2019.

⁸ Kjo dispozitë parashikon: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin

gjyqësor me praninë e palëve, për të riparuar të metat procedurale. Në zbatim të parashikimeve specifike të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Në këtë dritë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i provave dhe akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision, është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit ligjor dhe financiar të shkaqeve të ankimit nga Kolegji, sipas një leximi harmonik të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Kjo procedurë realizohet nga Kolegji në çdo rast, edhe pa qenë i nevojshëm zhvillimi i debatit gjyqësor me praninë e subjektit.

16. Trupi gjykues i Kolegjit thekson edhe që aktet bashkëlidhur parashtrimeve të datës 23.07.2021, nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit, çka mund të justifikonte mosparaqitjen e tyre gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, dhe për pasojë të kalonte testin e vendosur nga ligji nëpërmjet përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012⁹ për rrethanat në të cilat provat e reja mund të pranohen në ankim. Në dosjen e hetimit administrativ, përcjellë nga Komisioni, janë administruar akte dhe dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet publike dhe private, përfshirë edhe të dhënat mbi lëvizjet e llogarive bankare, të cilat mundësojnë kryerjen e një procesi verifikues dhe analizues të plotë, çka garanton trajtimin e çdo pretendimi që lidhet me pasaktësi të shifrave apo vlerave financiare. Ndërsa deklarata e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit mbi dinamikën e përdorimit të kredive në vitet 2008 dhe 2010, konfirmon qëndrimin e shprehur edhe më herët nga subjekti lidhur me vlerat e përdorura/të papërdorura të kredive në vitet respektive. Në vijim të analizës së shtjelluar më sipër, në dritën e dispozitave të sipërcituara që rregullojnë mënyrën e gjykimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi që gjykimi lidhur me këtë çështje të vijojë në dhomë këshillimi.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me të drejtat procedurale

17. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer shkelje të të drejtave procedurale, për rrjedhojë vendimi është i gabuar, i dhënë në kundërshtim me të drejtën materiale dhe procedurale, dhe në kundërshtim me të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja.* Sipas subjektit, Komisioni e ka kryer procesin e hetimit administrativ në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve dhe të gjykimit në seancë publike, meqenëse i ka njoftuar rezultatet e analizës financiare pasi është marrë vendimi për përfundimin e procesit të hetimit administrativ, duke mos vlerësuar si provë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së dhe aktin e ekspertimit kontabël të paraqitur nga subjekti. Seanca dëgjimore ka qenë fiktive meqenëse Komisioni nuk kishte shqyrtuar provat e paraqitura prej tij në përgjigje të barrës së provës, çka nuk i jepte mundësinë të debatonte apo të kërkonte sqarime në lidhje me to. Proces i rregullt ligjor, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve, sipas trajtimit të Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së është cenuar në themelin e tij. Komisioni nuk e ka vënë në dijeni për identitetin e personit që ka kryer analizën financiare apo rolin e kryer prej tij. Këshilltari ka rol ndihmës për trupin gjykues dhe nuk mund të ngarkohet

e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marrë nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

⁹ *“Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”*

me rolin e ekspertit. Ky i fundit ka njohuri të posaçme dhe përzgjidhet gjatë gjykimit për t'iu përgjigjur pyetjeve për çështjet për të cilat ai ka njohuri. Subjekti nuk kishte mundësi të kundërshtonte rezultatet e analizës financiare pasi Komisioni ka pasqyruar si në raport, ashtu edhe në vendim, vetëm përfundimin dhe jo provën, gjë që bie ndesh me parashikimet e nenit 20 e vijues të ligjit nr. 49/2012, sikurse referon neni 55, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

17.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka zhvilluar procesin e mbledhjes, verifikimit, analizës dhe shqyrtimit për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin për 13 muaj, përgjatë periudhës maj 2018 – qershor 2019. Ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit ka pasur shkëmbime intensive korrespondence. Gjatë këtyre shkëmbimeve, subjekti rezulton të ketë dhënë sqarime dhe informacion, por edhe ka përcjellë dokumentacion provues në përgjigje të 7 (shtatë) pyetësorëve¹⁰, është njohur me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe ka dhënë shpjegime në përgjigje të barrës së provës, të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ dhe të finalizuar me dëgjimin e shpjegimeve në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 15.07.2019. Nga pyetësorët, konstatohet se Komisioni ka kërkuar sqarime dhe dokumentacion justifikues mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë dhe deklaratën *vetting*, si dhe mbi përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm. Në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 15.07.2019, në të cilën subjekti i rivlerësimit mori pjesë, relatori është ndalur edhe në aspektet e procesit të rregullt ligjor në çështjen e subjektit të rivlerësimit, përfshirë: njoftimin për fillimin e procedurës së rivlerësimit, përbërjen e trupës gjykuese dhe faktin që për të nuk ka pasur asnjë deklaram konflikt interesi, kohën e lënë subjektit për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të marrë kopje të saj, provat e administruara, si dhe mundësinë që i është ofruar subjektit për të paraqitur prova apo shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht. Në përfundim të prezantimit, relatori ka përmbledhur kërkesat e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kundërshtimeve të analizës financiare të Komisionit, duke kërkuar kalimin e balancave negative në balanca pozitive. Relatori ka specifikuar edhe që në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka depozituar argumente dhe dokumentacion provues që do të vlerësohen para marrjes së vendimit përfundimtar.

17.2. Në vijim të fjalës së relatorit, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] *vlerësoj përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me të tre komponentët [...] veçanërisht me*

¹⁰ Më datë 04.05.2018, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur pyetësorit të parë standard të përcjellë nga Komisioni më datë 25.04.2018; më datë 15.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar përgjigjet dhe dokumentet shoqëruese për pyetësorin e dytë lidhur me pasuritë e paluajtshme, aktivitetet e ushtruara nga bashkëshortja dhe fëmijët, si dhe për vlerën e deklaruar të një automjeti [Mercedes Benz E 270 CDI] në emër të njërit prej djemve; më datë 09.04.2019, janë administruar përgjigjet dhe dokumentet shoqëruese të pyetësorit të tretë [datë 01.04.2019], së bashku me tabelën e udhëtimeve sipas sistemit TIMS, në funksion të qartësisimit të 10 pyetjeve lidhur me vlerat e investuara në banesa për mobilim dhe rikonstrukcionin dhe shtesën e deklaruar, vlerat e deklaruar të një automjeti në emër të njërit prej djemve, të dy automjeteve në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes; të dy automjeteve të tjera në emër të subjektit të rivlerësimit, vlerën e bonusit të përfituar për karburantin, kreditë e marra pranë NBG Bank dhe Fondit Besa, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për udhëtimet e kryera; më datë 24.05.2019, janë administruar përgjigjet dhe dokumentet shoqëruese të pyetësorit të katërt, në funksion të qartësisimit të 8 pyetjeve lidhur me shpenzimet dhe deklaratimet për ndërtimin e shtesës së apartamentit, për aktivitetin e bashkëshortes në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003, për burimin e financimit të tre automjeteve [Skoda Octavia, Opel Zafira dhe Fiat Punto]; më datë 31.05.2019, janë administruar përgjigjet dhe dokumentet shoqëruese të pyetësorit të pestë, në funksion të qartësisimit të 6 pyetjeve lidhur me kreditë e marra, pagesat dhe veprimet e kryera nga llogaritë bankare, jetesën me babanë dhe të ardhurat e përfituara prej tij, shpenzimet e mobilimit, deklarinimin e shitjes së njërit prej automjeteve [Opel Zafira]; janë administruar përgjigjet e pyetësorit të gjashtë, në funksion të qartësisimit të dy pyetjeve lidhur me mosdeklarimin e kredive të marra pranë Fondit Besa dhe ngarkesën e ulët të çështjeve penale të hetuara (10 çështje) gjatë 3 viteve sipas deklarinimit në formularin e vlerësimit të aftësive profesionale; më datë 17.06.2019 dhe 21.06.2019, janë administruar dokumentet shoqëruese të pyetësorit të shtatë, në funksion të qartësisimit të 4 pyetjeve lidhur me dokumentacionin justifikues për shpenzimet e udhëtimeve për periudhën 2004–2016, destinacionin e përdorimit të kredive të marra pranë Fondit Besa dhe pjesën e mbetur të kredive të marra pranë NBG Bank dhe BKT.

analizën lidhur me kriterin e pasurisë. Në parim, konstatohet që janë marrë në konsideratë elementet thelbësore të transaksioneve të kryera nga unë, pra për sa i përket pasurisë dhe anëtarëve të familjes, megjithatë në këtë analizë ka disa elemente që nuk janë marrë në konsideratë apo kanë nevojë për saktësime të mëtejshme [...]. Ky pohim dëshmon jo vetëm që subjektit i janë ofruar të gjitha garancitë për një proces të rregullt ligjor, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, barazisë së armëve dhe të gjykimit në seancë publike, por edhe që vetë subjekti rezultoi të jetë shprehur qartë për vlerësimin e tij mbi zbatimin e këtyre garancive nga Komisioni.

173. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij nuk janë vlerësuar nga Komisioni, se seanca dëgjimore ishte fiktive meqenëse provat e paraqitura prej tij, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, nuk ishin shqyrtuar paraprakisht, apo se Komisioni nuk ka pranuar të vlerësojë konkluzionet e aktit të ekspertimit të ekspertit kontabël, apo se rezultatet e analizës financiare i janë komunikuar pasi është marrë vendimi për përfundimin e procesit të hetimit administrativ, mbeten të pambështetura në prova dhe të paargumentuara. Kështu, procesverbalet e administruara në fashikull, konkretisht ai i mbledhjes së trupit gjykues më datë 11.07.2019 dhe ai i seancës dëgjimore të datës 15.07.2019, tregojnë që trupi gjykues ishte njohur paraprakisht me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti për elemente të caktuara të të ardhurave të deklaruara për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit – siç ishte kursimi nga pensioni i babait, i përfshirë në aktin e ekspertimit financiar në përgjigje të barrës së provës. Pjesë e rezultateve të hetimit administrativ ka qenë edhe analiza financiare për periudhën 2003 – 2016, e paraqitur në formë *narrative* dhe tabelare nga Komisioni, së bashku me metodikën e ndjekur, shpjegimet për vlerat dhe rezultatin e secilit vit. Sikurse konstatohet, analiza financiare e kryer nga Komisioni është bazuar në të dhënat e ekstraktuara nga deklarimet dhe dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit të hetimit. Logjikshëm, analiza financiare nuk mund të hartohet para se të administroheshin të gjitha të dhënat e nevojshme. Në të kundërt, në mungesë të dokumentacionit dhe shpjegimeve nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, rezultati i saj do të paragjykonte situatën financiare të subjektit.

174. Përpos kësaj, nga vendimi¹¹ rezultoi se Komisioni i ka konsideruar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bindëse dhe, për rrjedhojë, ka reduktuar në një raport të konsiderueshëm – me rreth 1/3 e totalit – balancën negative, nga (-) 6.535.235 lekë në vlerën përfundimtare (-) 4.197.149 lekë. Për këto arsye, është i pasaktë dhe i pabazuar edhe pretendimi i subjektit në parashtrimet e datës 23.07.2021, se vlera negative sipas analizës financiare ishte 6.535.235 lekë. Nga shqyrtimi i akteve rezultoi që Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të justifikuar vlerën negative prej 3.453.402 lekësh (shprehur në faqen 40 të rezultateve të hetimit administrativ). Në këtë akt, në faqet 27 – 39, pasqyrohen me detaje në formë *narrative* dhe tabelare vlerat dhe balancat financiare për secilin vit për periudhën 2003 – 2016, përfshirë edhe vitet me balancë financiare pozitive, sipas përlllogaritjeve paraprake të Komisionit. Vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e rezultateve, ka sqaruar me detaje të dhënat e çdo viti, përfshirë edhe vitet me balanca pozitive, duke kërkuar ndryshimin e vlerave konkrete për çdo vit. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se mospërputhja mes shifrave nuk mund të zhbëjë faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë i mirinformuar gjatë gjithë hetimit administrativ dhe i është dhënë mundësia të mbrohet plotësisht mbi këtë komponent të vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, subjektit i është garantuar zbatimi në praktikë i garancive për një proces të rregullt, të bazuar në parimin e kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve.

¹¹ Faqet 27-33 të vendimit të Komisionit në: <https://kpk.al/z-ardian-vlli-prokuror-drejtues-i-komanduar-i-prokurorise-prane-gjykates-se-rrethit-gjyqesor-vlore/>.

17.5. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, konstatohet se akti i ekspertimit kontabël i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është cituar shprehimisht, ndërkohë që ai është cituar disa herë nga relatori gjatë prezantimit të përmbajtjes së dosjes dhe në diskutimet e zhvilluara gjatë seancës dëgjimore. Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, megjithëse listimi në vendim i të gjitha akteve të mbledhura gjatë procesit është një praktikë e mirë arsyetimi, mungesa e citimit të shprehur nuk mund të argumentohet se e bën të pavlefshëm procesin apo vendimin e dhënë, sikurse nuk përbën as tregues të shkeljes së parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve, për aq sa vendimi përmbush kriteret e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016 – Komisioni ka cituar në tekst dhe në poshtëshënime aktet të cilat është referuar për ekstraktimin e të dhënave me qëllim kryerjen e vlerësimit ligjor dhe financiar.

17.6. Lidhur me pretendimet për rolin e këshilltarit, trupi gjykues i Kolegjit thekson se analiza financiare është pjesë e detyrave që kryhen nga Njësia e Shërbimit Ligjor sipas nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të studimit të dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Me marrjen e analizës financiare paraprake, subjektit të rivlerësimit i mundësohet përmbushja e barrës së provës dhe njohja me mangësitë e konstatuara në provueshmërinë e të ardhurave nga burimet e ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara. Analiza financiare e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk njësohet me aktin e ekspertimit që harton eksperti në gjykata. Për rrjedhojë, analiza e kryer në funksion të vendimmarrjes së Komisionit, nuk i nënshtrohet regjimit ligjor të përcaktuar nga legjislacioni procedural civil, penal apo administrativ.

17.7. Lidhur me pretendimet për konsiderimin e raportit të ILDKPKI-së, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka shtjelluar në faqet 5 – 6 të vendimit hetimet e pavarura të kryera në funksion të procesit të rivlerësimit, përfshirë edhe analizën e raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja, deklaratën e pasurisë dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, provat shkresore të administruara në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016 nga institucionet qendrore shtetërore, bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore dhe drejtoritë rajonale, institucionet dhe entet publike, zyra noteriale etj., deklaratimet, provat, shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore. Vlera dhe vendi që zë raportit i kontrollit të kryer nga ana e ILDKPKI-së në raport me vlerësimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit të kryer nga institucionet e rivlerësimit, është elaboruar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas së cilës kontrollin e plotë të procesit të rivlerësimit e kanë organet e rivlerësimit.

17.8. Në vijim, duke pasur parasysh edhe zbërthimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së¹², mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, mundësia e arsyeshme që u jepet palëve për të paraqitur deklaratimet, provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, si dhe pjesëmarrja në një proces dëgjimor, pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë.

- 18.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimit i mungon objektiviteti dhe proporcionaliteti, referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Vendimi bazohet vetëm në rezultatet e hetimit administrativ, pa u dhënë rëndësi provave të paraqitura prej tij, pretendon subjekti. Ai i referohet raportit të ILDKPKI-së dhe aktit të ekspertimit të sjellë prej tij, hartuar nga një prej shoqërive audituese “më prestigjioze”. Komisioni ka shkelur parimet mbi bazën e të cilave vlerësohen provat dhe ka mbivlerësuar apo dhënë përparësi konkluzioneve të këshilltarit*

¹² *Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës etj.*

ekonomik të Komisionit. Subjekti i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të shprehur në vendimin nr. 12/2003.

181. Në vijim të analizës së kryer në paragrafin e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në prova dhe ligj. Pretendimi për shkelje të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, dhe paragjykim të çështjes meqenëse, sipas subjektit, Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim aktin e ekspertimit dhe raportin e ILDKPKI-së, është i pabazuar. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së fashikujve dhe përmbajtjes së vendimit, rezulton në fakt e kundërta. Konkretisht, në kundërshtim me detyrimet që përcakton neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 për ta bazuar vendimin në dokumente dhe prova të besueshme, Komisioni ka pranuar deklarime të paprovuara me akte dhe dokumente shpresore të subjektit, në favor të analizës financiare të pretenduar prej tij. Kështu, Komisioni ka pranuar si të provuara kursimet e pretenduara të përfituara nga subjekti nga pensioni i babait deri në vitin 2002 [në vlerën 300.000 lekë], dhe periudhën kohore gjatë së cilës ato janë përdorur – duke i përfshirë në analizën financiare të vitit 2003, siç ka kërkuar subjekti. Komisioni po ashtu ka zbritur shpenzimet për blerje jashtë Shqipërisë, sipas pretendimit të subjektit se janë për të tretë, ashtu si dhe reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve familjare, bazuar në deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti gjatë procesit të hetimit. Së fundmi, konstatohet se Komisioni i ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2007 sipas të dhënave të vitit 2006, duke zhvlerësuar standardet e raportuara nga i vetmi institucion i specializuar – INSTAT – dhe të përdorura ndër vite, me arsyetimin se vlera e përlllogaritur është “dukshëm jo e saktë”, pasi duhet të ishte nën nivelin e vlerave zyrtare¹³, të përcjella nga INSTAT-i ILDKPKI-së ndër vite. Kjo zgjedhje e Komisionit, në rastin e subjektit të rivlerësimit, bie ndesh me mënyrën e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit. Pavarësisht nga ky konstatim, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që ky element i përlllogaritjes së analizës financiare, duke mos qenë shkak ankimi, nuk ka ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit.

182. Nga ana tjetër, sipas ligjit nr. 84/2016, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni ka vlerësuar se ka mjaftueshëm elemente për të konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Ky pretendim është elaboruar më poshtë gjerësisht, përgjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin në themel të kriterit të pasurisë.

183. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, nuk konstatohet që Komisioni t’u ketë dhënë vlerë të paracaktuar provave të administruara. Në rubrikën IV, faqe 4, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka sqaruar se duke qenë se ligji përcakton tagrin për të realizuar një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pasurisë, që shkon përtej atij të kryer nga ILDKPKI-ja, vlerësimi i kryer mund të jetë i ndryshëm. Nga ana tjetër, nëse do të pranohej ky këndvështrim i subjektit, konkretisht, që vlerësimi i kryer nga organet ndihmëse të specializuara është përfundimtar, procesi i rivlerësimit do të ishte një mbledhje mekanike e raporteve të tri institucioneve të specializuara për secilin kriter. Në përputhje me parashikimet e neneve 45, 50, 52 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit kanë tagrin të hetojnë dhe të vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, të kërkojnë informacion dhe të bashkëpunojnë me organet shtetërore dhe private, brenda apo jashtë vendit, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit, dhe t’i kalojnë barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar

¹³ Për vitin 2007 konsumi për frymë është në vlerën 235.968 lekë, ndërsa për vitin 2006 është në vlerën 136.620 lekë – faqe 23 e vendimit.

të kundërtën e gjetjeve dhe të nxjerrin vendim të arsyetuar. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

18.4. Sikurse është trajtuar edhe më sipër, analiza financiare e Komisionit, e hartuar në përfundim të hetimit administrativ, është bazuar në të dhënat dhe informacionet e derivuara nga aktet e administruara. Në këtë fazë të procesit, në kushtet kur analiza i nënshtrohet shqyrtimit dhe prapësimeve, sipas rastit, nga ana e subjektit, ajo nuk mund të përbëjë një akt përfundimtar. Akti përfundimtar i procesit mbetet vendimi i dhënë sipas përcaktimeve të nenit 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në prova dhe ligj.

- 19.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.* Të njëjtët anëtarë të trupit gjykues kanë kryer hetimin, kanë mbledhur provat, kanë ngritur dyshimet dhe kanë dhënë edhe vendimin përfundimtar, në konflikt të hapur interesi dhe në kundërshtim me parimet e kontradiktoria litetit, gjykimin të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë. Ky fakt, sipas subjektit, dëshmon se ai nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj sipas përcaktimeve të nenit 6/1 të KEDNj-së dhe praktikës së konsoliduar të GjEDNj-së. Qëndrimi i Komisioni ka qenë i njëanshëm, i pabarabartë dhe diskriminues pasi në raste të ngjashme, diferencat financiare në vlera të përafërta me të tija, nuk janë konsideruar të mjaftueshme (referuar vendimit nr. 169/2019¹⁴). Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka në përbërje të tij gjyqtarë, gjë që bie ndesh me praktikën e GjEDNj-së, sipas së cilës organet që dispijlojnë gjyqtarët duhet të përbëhen në masë thelbësore nga gjyqtarë. Këto argumente, subjekti i mbështet në jurisprudencën së GjEDNj-së: në Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës 2006, Olujic kundër Kroacisë 2009, Mishgijoni kundër Shqipërisë 2010, Zalli kundër Shqipërisë 2011, Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Micallef kundër Maltës 2009, Volkov kundër Ukrainës 2013, Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës 2019, Kartën Evropiane mbi Statusin për Gjyqtarët, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010), si dhe opinionet e Komisionit të Venecias sikurse Opinioni i Ndërmjetëm §§ 109 - 116 dhe Opinioni Përfundimtar §§ 64 – 68, nr. 824/2015, Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, ndër të tjera.

19.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky grup pretendimesh lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Sjellim në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paansisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias¹⁵, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese¹⁶ dhe së fundmi edhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë¹⁷. Në këtë të fundit, GjEDNJ -ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Përpos kësaj, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm adresohen edhe nga Kolegji. Pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton, shqyrton dhe vendos, është i pabazuar. Referuar jurisprudencës së GjEDNJ-së, ndër të

¹⁴ Vendimi që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti: <https://kpk.al/znj-regleta-panajoti-gjyqtare-ne-gjykatene-rrethit-gjyqesor-tirane/>.

¹⁵ [https://www.venice.coe.int/webforms/document/default.aspx?pdfid=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/document/default.aspx?pdfid=CDL-AD(2016)036-e).

¹⁶ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017 – http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

¹⁷ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabvie%22:%7B%22document%22:%7B%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D%7D>.

tjera në *Morel kundër Francës, Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar¹⁸. Në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar tashmë filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

20. Në përfundim të analizës së pretendimeve për shkelje të parimeve procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe akteve të shqyrtuara, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka zhvilluar procedurën sipas parashikimeve ligjore dhe është kujdesur për garantimin e të drejtave të subjektit për një proces të rregullt ligjor.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me interpretime ligjore të vendimit të Komisionit

21. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i pambështetur në provat e administruara, në Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016 dhe në kuadrin ligjor shoqëruar.* Sipas subjektit të rivlerësimit, shkarkimi nga detyra nuk mund të bazohet në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni i referohet deklaramentit të pamjaftueshëm, ndërsa shprehet për mungesë të burimeve të ligjshme financiare [në vlerën 4.197.149 lekë], shkak që lidhet me nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, çka përbën një interpretim të zgjeruar, në dëm, dhe më të ashpër për subjektin. Subjekti i rivlerësimit argumenton se asnjë sanksion nuk mund të zbatohet në rast se institucionet verifikuese nuk gjejnë dëshmi pozitive se ai ka paraqitur të dhëna të rreme me qëllim fshehjen e pasurisë. Dispozitat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës [pikat 1 dhe 4] paraqesin një ndarje të qartë ndërmjet dy fazave – momentin e deklaramentit dhe momentin e justifikimit të asaj që është deklaruar; pikat 2 dhe 3 rregullojnë përkatësisht dhënien e informacioneve shpjeguese, sjellje kjo me natyrë deklaruese, dhe disiplinimin e justifikimit, sjellje kjo me natyrë shpjeguese, dëshmuuese. Pika 5 sanksionon shkeljet e parimeve deklaruese, duke parashikuar shkarkimin për ato subjekte, të cilat kanë ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë të pasuritë. Sipas subjektit, “standardi i dyfishit të pasurisë” është vendosur për të shmangur qëndrimet subjektive lidhur me “nivelin e besueshëm” të pasurisë, duke marrë për bazë edhe shkallën e lartë të informalitetit dhe kushtet historike dhe shoqërore të Shqipërisë pas viteve ‘90. Interpretimi i nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 duhet të bëhet në përputhje me parashikimet kushtetuese të Aneksit dhe nuk mund jepet kuptim më i zgjeruar se ai që parashikon neni D.

21.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, nëpërmjet së cilës ka shtjelluar në mënyrë shteruese rëndësinë vendimtare që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramenteve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpejgimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë¹⁹. Në analizë të interpretimit që subjekti i rivlerësimit i ka bërë nenit D të Aneksit të Kushtetutës, edhe nga një lexim i thjeshtë i paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, del qartë që secili prej tyre normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, me elemente specifike dhe të pavarura, të cilat zbërthehen në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 – pikat 1 dhe 3. Ndër to, respektivisht, i pari lidhet me

¹⁸ Paragrafët 142 – 163 të udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) – https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQL.pdf.

¹⁹ Shih vendimin nr. 19/2019.

dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndërsa tjetri me pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë²⁰. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, nuk konstatohet që Komisioni të ketë kryer interpretim të zgjeruar të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Përkundrazi, situatat e përshkuara në vendim, mbështesin përfundimin e Komisionit për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me deklaramin e pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar përcaktimeve të nenit 33 të po këtij ligji. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

22. *Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi është i padrejtë, i paracaktuar dhe jologjik.* Nga njëra anë, Komisioni shprehet se shtesat dhe likuidimet në vite janë të sakta, dhe nga ana tjetër, pasi analizohet përputhshmëria e tyre me deklaratën *vetting*, tabela paraqet diferenca. Vetëm mosdeklarimi i dy kredive të marra në vitet 2004 dhe 2009 nuk mund të konsiderohet deklarim i pamjaftueshëm pasi nuk ka qenë qëllim fshehja e tyre; ato rrjedhin nga burim i ligjshëm, janë në vlera të vogla (200.000 lekë dhe 300.000 lekë) dhe lehtësisht të verifikueshme.

22.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklarimi i pasaktë, i paplotë dhe/apo i pavërtetë në deklaratat e interesave privatë periodikë, lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë që kanë subjektet deklaruese për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003. Pavarësisht se provueshmëria e kredisë është lehtësisht e vërtetueshme nga dokumentacioni i përpiluar nga institucionet financiare kredidhënëse, subjekti duhet ta kishte deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë, në vijim të detyrimeve ligjore që ka përcaktuar ligji nr. 9049/2003. Megjithatë, kontrolli i saktësisë së plotësisht të deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë nuk është objekt i zbatimit të ligjit nr. 84/2016, me pasojë dhënien e masës disiplinore. Vlerësimi i përmbajtjes së tyre si prova bëhet vetëm në funksion të kontrollit të saktësisë së plotësisht nga subjektet e rivlerësimit, të deklaratës së pasurisë *vetting*.

23. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, aplikohet kur pamjaftueshmëria në deklarime qëndron njëkohësisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe për kriterin e kontrollit të figurës.* Këto dy elemente janë parashikuar në të njëjtën dispozitë, duke përdorur lidhëzën “dhe”. Në të kundërt, do të veprime sikurse është parashikuar më vete shkak i shkarkimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale (pika 4). Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse për shkarkim do të mjaftonte vetëm deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, legjislatori nuk do të parashikonte deklarimin e dyfishit të pasurisë (pika 1) si shkak më vete. Do të ishte i pamjaftueshëm deklarimi i pamjaftueshëm, pasi deklarimi me dyfishin e pasurisë do të konsiderohej deklarim i pamjaftueshëm, nëse një subjekt nuk e justifikon pasurinë me burime të ligjshme. Në të njëjtën logjikë interpretohet edhe parashikimi i pikës 2, lidhur me kontrollin e figurës. Sipas subjektit, aplikimi i pikës 3 bëhet në prezumimin kur deklarimi për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë është i pamjaftueshëm, atëherë pasuria mund të jetë rezultat i abuzimit me detyrën, çka përbën edhe qëllimin e vetë ligjit. Në rastin e tij, Komisioni e ka konsideruar të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës për kriterin e kontrollit të figurës.

23.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është trajtuar tashmë gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit²¹, ku është theksuar se pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës për këto dy kriteret, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë përbën një zbatim të përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në nivelin e ligjit, i cili parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të

²⁰ *Idem.*

²¹ *Shih vendimet nr. 1/2021, 26/2020 etj.*

shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, rregullohet në një nen të dedikuar të Aneksit të Kushtetutës, në nenin Dh. Për shkak të drejtimit të qartë që jep Aneksi i Kushtetutës, për këto dy kritere – deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës – nuk mund të argumentohet se duhet të interpretohen në mënyrë kumulative. Me fjalë të tjera, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, këto dy kritere nuk kërkojnë doemos praninë e njëri-tjetrit për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm. Më tej, neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethanat faktike dhe ligjore në të cilat organet e rivlerësimit duhet automatikisht dhe pa ushtruar diskrecion, të zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

24. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se shkak i vetëm mbi bazën e të cilit mund të vendoset shkarkimi nga detyra për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është ajo e parashikuar në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 që lidhet me dyfishin e pasurisë. Në rastin konkret, edhe nëse merret e mirëqenë diferenca negative e rezultuar nga analiza e Komisionit, ajo përbën afërsisht 8% të të ardhurave, që është larg standardit të dyfishit të pasurisë së ligjshme që subjekti zotëron.*

24.1. Referuar analizës së kryer në paragrafët e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shkaqet mbi bazën e të cilave mund të jepet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e pasurisë, janë ato të parashikuara nga neni 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, të cilat rrjedhin nga situata specifike të caktuara e të ndryshme. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të pasurisë për shkak të pamundësisë për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara, në vlerën negative prej 4.197.149 lekësh, dhe se në dy deklaratat të interesave privatë [2004 dhe 2006] nuk ka deklaruar dy kreditë e marra nga bashkëshortja pranë Fondit Besa. Nga ana tjetër, standardi i dyfishit të pasurisë është një dispozitë autonome, që zbatohet në rrethana faktike specifike, në të cilat organet e rivlerësimit nuk gëzojnë diskrecion. Kolegji tanimë ka jurisprudencë të konsoliduar në interpretimin dhe zbatimin në praktikë të pikës 1 kundrejt pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion të sa më sipër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

25. Në përmbledhje të gjithë analizës së mësipërme, si dhe në referencë edhe të jurisprudencës së konsoliduar dhe të gjerë të Kolegjit, lidhur me zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në ankim për interpretime të ligjit nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Ç. *Shkaqet në ankim që lidhen me vlerësimin e pasurisë*

26. *Për sa i përket vlerësimit të pasurisë në themel, subjekti i rivlerësimit argumenton se Komisioni nuk ka vlerësuar drejt të ardhurat dhe përdorimin e tyre. Ky konstatim, sipas subjektit, rezulton nga fakti që Komisioni nuk ka pranuar kursimet në shumën 300.000 lekë nga pensioni i babait në vitet 1982 – 2002 apo të ardhurat nga pensioni për vitet 2003 deri në vitin 2012, po ashtu të kursyera dhe përdorura ndër vite nga subjekti i rivlerësimit. Në të ardhurat në dispozicion të subjektit në vitin 2012, nuk është përfshirë shuma 750.000 lekë, mbledhur nga ceremonia mortore e babait dhe e përdorur në të njëjtin vit, duke mundësuar rritje të kursimeve familjare në vitet 2012 dhe 2013, përkatësisht në vlerat 500.000 lekë dhe 240.000 lekë – të cilat janë shumatat e deklaruara në *cash* në deklaratat e interesave privatë si *kursime*. Subjekti parashtron se të ardhurat e babait janë kursyer, ndërsa shpenzimet e jetesës për të janë mbuluar nga të ardhurat e krijuara prej tij [subjektit], bashkëshortes dhe djalit të madh. Shpenzimi dhe kursimi janë kushtëzuar nga nevojat e shpenzimet familjare. Për pasojë, nuk qëndron arsyetimi i Komisionit se shpjegimet e subjektit për mënyrën e kursimit e përdorimit të të ardhurave, janë*

përshtatur në funksion të analizës financiare. Komisioni duhet të kishte pranuar shpjegimet e subjektit dhe përlllogaritur fondet nga pensioni i babait sipas pretendimeve të tij. Komisioni nuk ka administruar asnjë provë që të provojë faktin apo dyshimin se këto të ardhura nuk janë përdorur në mënyrën e deklaruar. Në këtë mënyrë, sjell në vëmendje subjekti, Komisioni ka përdorur dy standarde për sa i përket pranueshmërisë së deklarimeve dhe shpjegimeve të dhëna prej tij. Kështu, për mënyrën e shpërndarjes së shpenzimeve të mobilimit janë marrë në konsideratë deklarimet e tij, ndërsa për mënyrën e përdorimit dhe shpërndarjes së të ardhurave nga pensioni i babait, deklarimet e tij nuk janë marrë në konsideratë, pavarësisht se ka paraqitur prova.

26.1 Lidhur me pretendimin për mënyrën e shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave nga pensioni i babait, trupi gjykues vëren se:

i) Nga shqyrtimi i përmbajtjes së akteve të administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar për herë të parë përfitimet nga të ardhurat e pensionit të të atit në përgjigje të pyetësorit nr. 4 dhe atij nr. 5²². Në këta pyetësorë, subjekti ka pretenduar kontributet e babait për periudhën 2003-2012 dhe rreth 300.000 lekë. Po aty, subjekti është shprehur që i ati i kishte kursyer dhe i kishte vënë në dispozicion të ekonomisë familjare këto fonde. Për të provuar këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit u ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit shkresa dhe vërtetime të lëshuara nga entet, sikurse UKT, OSHEE, Albtelekom, nga strukturat e njësisë së pushtetit vendor, nga ISSH²³, si dhe 6 deklarata noteriale, që mbajnë datën 30.05.2019, nga të afërm dhe fqinjë.

ii) Në analizën financiare në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka përfshirë të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet e subjektit dhe bashkëshortes, si dhe të ardhura nga pensioni i babait për vitin 2003. Rezultati financiar për vitin 2003 rezulton me vlerë negative (-) 597.801 lekë. Komisioni nuk ka përfshirë kursime apo gjendje *cash*/likuiditete. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se investimet e kryera në vitin 2003, për mobilim dhe blerje automjeti, janë përballuar nga kursimet familjare të krijuara *deri* në këtë vit, të cilat kanë qenë në shumën rreth 700.000 lekë – nga të ardhurat para vitit 2003, përkatësisht 300.000 lekë kursime të babait dhe 700.000 lekë kursime të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Komisioni ka rishikuar analizën financiare për periudhën para vitit 2003, duke konkluduar se subjekti ka pasur mundësi t'i krijonte këto kursime. Në vijim, Komisioni e ka ndryshuar analizën financiare për vitin 2003 duke përlllogaritur të mirëqenë vlerën 1.000.000 lekë (300.000 lekë nga të ardhurat e pensionit të babait dhe 700.000 lekë kursime të subjektit dhe bashkëshortes së tij), si shtesa/pakësime/likuiditeti. Për rrjedhojë, rezultati financiar për këtë vit ka rezultuar pozitiv, sipas Komisionit. Po kështu, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 2003 – 2012, konstatohet se janë përfshirë në rubrikën e të ardhurave, në një zë të posaçëm, “të ardhurat nga pensioni i babait”, sipas të dhënave të konfirmuara nga ISSH-ja.

iii) Nga shqyrtimi i deklaratës së interesave privatë për vitin 2003, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm të ardhurat nga punësimi i tij dhe i bashkëshortes, ndërsa gjendje *cash* apo likuiditete nuk është deklaruar në asnjë formë, qoftë si kursim familjar prej

²² Fillimisht, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimet e financimit të një automjeti [Fiat Punto] kanë qenë të ardhurat familjare të vitit, përfshirë edhe të ardhurat e pensionit të babait ndër vite. Subjekti ka shpjeguar se ka jetuar me të atin nga viti 1975 deri në vitin 2012 dhe se i ati ka pasur pension të konsiderueshëm dhe ka kontribuar në ekonominë familjare.

²³ Subjekti ka paraqitur dy akte nga ISSH-ja [me shkresat datë 06.05.2019 dhe datë 08.05.2019], nëpërmjet të cilave konfirmohet që babai i subjektit është trajtuar me pension pleqërie nga data 01.11.1982 deri më datë 24.01.2012, në masën 26.011 lekë, dhe ka përfituar gjithsej 3.236.482 lekë, si dhe me pension suplementar nga data 01.07.2009 deri në datën 24.01.2012, në masën 10.720 lekë në muaj, duke përfituar gjithsej 315.173 lekë. Këto akte janë paraqitur nga subjekti.

tij dhe bashkëshortes, apo me burim nga pensioni i të atit. Burim për blerjen e automjetit [“Reno”] janë deklaruar *kursime*, pa u specifikuar prejardhja. Në përgjithësi, në deklaratat e interesave privatë ndër vite, përfshirë edhe vitin 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura të akumuluar nga pensioni i të atit në asnjë formë, qoftë si “fond kursimi” apo t’i jetë referuar si “burim për të ardhurat/kursimet” përgjatë këtyre viteve. Pretendimi për ekzistencën e tyre si fond në dispozicion të familjes, është parashtruar për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit dhe ka vijuar në ankim. Përpos kësaj, nga fashikujt, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë asnjë dokument apo akt të kohës që të vërtetojë pretendimet e tij se ka pasur gjendje të kursyer, me burim krijimi nga pensioni i të atit në vitin 2003 dhe në vitet në vijim, qoftë edhe në formën e shpërndarjes së tyre, sikurse e ka prezantuar në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ apo në përmbajtjen e ankimit.

iv) Pavarësisht se këto pretendime janë ngritur për herë të parë nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni rezulton t’i ketë konsideruar këto shpjegime *bindëse* – pjesërisht – duke ndryshuar rezultatin përfundimtar për vitin 2003. Konkretisht, Komisioni ka gjetur se ishin *bindëse* shpjegimet e subjektit lidhur me vlerën e kursimeve familjare prej 700.000 lekësh, deri në vitin 2003 – me arsyetimin se familja mund t’i krijonte këto kursime deri në vitin 2003 – dhe vlerën prej 300.000 lekësh, në formën e kursimeve të rrjedhura nga pensioni i të atit për periudhën 1982 – 2002, ndërkohë që ka konsideruar *jobindëse* e të paprovuar me dokumentacion dhe në funksion të analizës financiare pas njohjes me rezultatet paraprake të hetimit, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pensionet në disa vite janë kursyer dhe në disa vite janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve familjare, sipas tabelës që ai ka vënë në dispozicion, në përgjigje të barrës së provës (të njëjta të dhëna në format tabelar subjekti i ka përfshirë edhe në ankim).

v) Ndodhur në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur subjekti gjatë deklaratave periodike nuk ka deklaruar këtë të ardhur apo nuk e ka referuar ndonjëherë në ndonjë formë si burim për krijimin e kursimeve të pretenduara deri në vitin 2003, por edhe për kursimet ndër vite apo përdorimin e tyre, të paktën deri në vitin 2014, ky pretendim i subjektit nuk është bindës. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite²⁴, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vepruar drejt që nuk ka pranuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave, në disa vite, pensionet janë kursyer dhe në disa vite të tjera janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve familjare. Kjo mënyrë paraqitjeje e të ardhurave nuk mund të gjejë pasqyrim në analizën financiare, pasi nuk është deklaruar në çfarëdolloj forme apo mënyre nga ana e subjektit në kohën kur ato janë poseduar apo përdorur. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pambështetura në prova dhe mbeten në nivel deklarativ.

26.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni përdor dy standarde në pranimin e shpjegimeve të tij, meqenëse janë pranuar shpjegimet për mënyrën e shpërndarjes së shpenzimeve të mobilimit, ndërsa shpjegimet për mënyrën e përdorimit dhe shpërndarjes së të ardhurave nga pensioni i babait janë konsideruar *jobindëse*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

i) Në kuadër të procesit të rivlerësimit, detyrimi i subjektit të rivlerësimit është të shpjegojë dhe të provojë bindshëm pasuritë e krijuara, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë edhe interesat privatë të tij dhe të personave të lidhur me të. Nga ana tjetër, duke filluar nga viti 2012, në kuadër të plotësimit të

²⁴ Shih, ndër të tjera, vendimet që u përkasën subjekteve të rivlerësimit Besa Nikëhasani [JR nr. 6/2018], Luan Kaloçi [JR nr. 8/2018], Altina Xhoxhaj [JR nr. 9/2018], Tom Ndreca [JR nr. 11/2018], Bashkim Dedja [JR nr. 12/2018], Adriatik Cama [JR nr. 5/2019], Xhezair Zaganjori [JRnr. 19/2019], Gentjan Osmani [JR nr. 20/2019], Adnand Kosova [Jr nr. 5/2020] dhe Dritan Peka [JR nr. 27/2020].

saktë dhe të plotë të deklaratave të interesave privatë/periodikë që dorëzohen në ILDKPKI, subjektet deklaruese kanë detyrimin që, përpos pasurive, të ardhurave, burimit të krijimit të tyre, detyrimeve financiare etj., të deklarojnë edhe çdo shpenzim të deklarueshëm të kryer gjatë vitit të deklarimit²⁵, me vlerë mbi 500.000 lekë²⁶, dhe prej vitit 2014 me vlerë 300.000 lekë²⁷. Përrjedhë, në kushtet kur deri në plotësimin e deklaratës së interesave privatë për vitin 2012, deklarimi i shpenzimeve nën vlerën 500.000 lekë, apo nën vlerën 300.000 lekë prej vitit 2014 – përfshirë edhe shpenzimet e mobilimit – nuk ka qenë detyrim ligjor, në pamundësi për ta konfirmuar me deklaratat ndër vite, vlera e tyre do të përfshihet në analizën financiare sipas deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Në këtë aspekt, jo pa qëllim, dy nga pyetjet standarde të Komisionit (pyetja nr. 6 dhe nr. 11 e pyetësorit nr. 1) lidhen me deklarimin nga subjekti të shpenzimeve që tejkalojnë vlerën 2.500 euro në 7 vitet e fundit dhe nëse ka kryer t’i listojë ato, përfshirë edhe qëllimin e shpenzimit, si dhe të deklarojë vlerën e arredimit të shtëpisë, duke specifikuar natyrën dhe koston e çdo rinovimi, orendive, dekorimeve dhe pajisjeve elektrike apo elektronike kur vlera e secilës prej tyre e tejkalon shumën 2500 euro për 5 vitet e fundit, duke vënë në dispozicion edhe faturat, për sa është e mundur. Përrjedhë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

26.3 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit që, në të ardhurat e vitit 2012, të përfshihet shuma prej 750.000 lekësh, trupi gjykues vëren se:

i) Subjekti pretendon se gjatë vizitave në ditët e ceremonisë mortore të babait të tij, të afërm e miq kanë dhënë shuma të konsiderueshme në vlera monetare, në shenjë respekti. Shuma neto, pasi janë zbritur shpenzimet mortore, ka qenë në vlerën “rreth/mbi” 750.000 lekë. Sipas tij, këto të ardhura nuk janë deklaruar te të ardhurat, por si rritje e kursimeve në deklaratat e interesave privatë të viteve 2012 dhe 2013, përkatësisht në vlerën 500.000 lekë dhe 240.000 lekë. Kjo vlerë, pretendon subjekti, është konsumuar brenda vitit 2012 për shpenzime familjare dhe ka mundësuar kursime të të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes nga puna apo aktiviteti i saj. Në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura rrjedhin nga një burim i ligjshëm dhe i tatueshëm.

ii) Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë për vitet 2012, 2013 dhe 2014, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë kursimesh. Konkretisht, për vitin 2012, kursimet janë shtuar me 500.000 lekë (duke e çuar vlerën e kursimeve vjetore të deklaruara në vite në shumën 2.400.000 lekë); për vitin 2013, kursimet janë shtuar në shumën 240.000 lekë; ndërsa për vitin 2014, kursimet janë shtuar në shumën 550.000 lekë. Në të tria këto deklarata, subjekti *nuk* ka deklaruar burimin e krijimit të kursimeve, sipas detyrimit të parashikuar nga ligji nr. 9049/2003²⁸ dhe pasqyruar më tej edhe në formularin e deklarimit të pasurisë, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe burimit të krijimit. Ky fond i dhuruar nuk ka gjetur pasqyrim as në deklaratën e pasurisë (*vetting*). Gjatë procesit të rivlerësimit, për të vërtetuar pretendimet mbi krijimin e kursimeve familjare dhe ekzistencën e shumës së pretenduar gjatë ceremonisë mortore (rreth 1.000.000 lekë), subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë

²⁵ "Shpenzimi i deklarueshëm" është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues – neni 1 i ligjit nr. 85/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar".

²⁶ Neni 3 i ligjit nr. nr. 85/2012.

²⁷ Neni 2 i ligjit nr. 45/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar".

²⁸ Neni 1 i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar parashikon: "Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, [...]". Neni 4 i po këtij ligji parashikon "Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në [...], brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare [...]".

deklaratash noteriale, të lëshuara në muajin korrik 2019, nga të afërm dhe miq të tij, të cilët deklarojnë të kenë qenë të pranishëm në këtë ceremoni.

iii) Në kushtet kur kjo e ardhur është deklaruar për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit²⁹, përpos jurisprudencës së Kolegjit mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite, trupi gjykues sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e konsoliduar për vlerën e kufizuar të deklaratave noteriale të paraqitura nga subjektet gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat janë vlerësuar përgjithësisht si përpjekje për të justifikuar qëndrimin e subjektit³⁰. Në këtë kontekst rrethanash, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se me të drejtë Komisioni ka konstatuar se shpjegimet e subjektit nuk u dukën bindëse, pasi vlerat financiare janë shpërndarë ndër vite, duke iu referuar situatës financiare negative nga analiza e kryer. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten të pambështetura në prova.

27. *Sipas subjektit, Komisioni ka gabuar duke mos pranuar pretendimin e tij që kreditë janë përdorur për mbulimin e nevojave financiare të familjes, por edhe të biznesit.* Një pjesë e fondeve të kredisë janë përdorur edhe në vitin pasardhës, sipas subjektit. Për rrjedhojë, subjekti kërkon që në fondet e përllogaritura të marra hua gjatë vitit 2007, të pakësohen, ndërsa ato të përdorura në vitin 2008 të shtohen në vlerën 450.000 lekë, shumë e rrjedhur nga kredia prej 15.000 eurosh, e marrë në vitin 2007 nga NGB Bank. Në të njëjtën logjikë, subjekti kërkon që nga llogaria financiare për vitin 2009, të pakësohen fondet e marra hua gjatë atij viti [përkatesisht në muajt shkurt dhe qershor 2009], ndërsa fondet e përdorura gjatë vitit 2010 të shtohen në vlerën 500.000 lekë. Kjo shumë është pjesë e kredive të marra në vitin 2009, në vlerat respektive 300.000 lekë dhe 500.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit argumenton se kreditë janë deklaruar si të ardhura në vitin kur janë marrë, dhe nëse do të deklarohesh pjesa e kredisë e konsumuar atë vit si kursim në *cash*, për të justifikuar përdorimin e saj në vitin pasardhës, do të zbalancohej deklarimi dhe në këtë mënyrë një pjesë e fondeve të kredisë do të figuronte 2 herë si e hyrë [e ardhur]. Subjekti argumenton se për deklarimet e tij, fakti që kanë kaluar 11 vjet nga periudha në fjalë, do të duhet të interpretohet duke u dhënë prioritet shpjegimeve të tij në procesin e rivlerësimit për destinimin dhe mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve – dhe jo atyre të kohës. Këto fonde, parashtron subjekti, janë përdorur në vitin pasardhës, për shlyerjen e kësteve të planifikuara të kësaj kredie.

27.1. Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë informacion lidhur me kreditë e marra, përfshirë vlerën e shlyer dhe vlerën e mbetur. Në asnjë nga këto deklarata nuk rezulton që subjekti të ketë dhënë qoftë edhe në formë shënimi sqarues/qartësues çfarë ka parashtruar gjatë procesit

²⁹ Në ndryshim nga pretendimet e tij në pyetësorë e më tej, në parashtrimet në Kolegjin përpara seancës në dhomë këshillimi [përcjellë më datë 23.07.2021], subjekti i rivlerësimit pretendoi që shuma është përdorur në vitin 2012, duke i dhënë mundësinë e rritjes së kursimit për këtë vit, në shumën 500.000 lekë, nga të ardhurat e krijuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

³⁰ Shih paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani, dhe paragrafin 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, vendime të marra përpara vendimit objekt ankimi. Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini, paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena, paragrafët 57 dhe 75 në vendimin nr. 3/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit Enkeledi Hajro; paragrafin 102 në vendimin nr. 4/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beci; paragrafët 22.5 dhe 26.2 të vendimit nr. 8/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit Idriz Mulkurti; paragrafin 20.2 në vendimin nr. 11/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri.

të rivlerësimit – konkretisht *vlera të papërdorura* apo të mbajtura në formë kursimi *cash*, sikurse e ka parashtruar edhe në ankim. Ndërkohë, trupi gjykues i Kolegjit vëren që edhe për sa i përket burimit të kursimeve të deklaruara në vitet në fjalë në deklaratat e interesave privatë [për vitin 2009 dhe 2010], subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre. Përjashtim bën deklarata periodike e vitit 2007 kur, për kursimet e deklaruara, subjekti ka referuar “nga pagat familjare”. Për vitin 2008, subjekti nuk ka deklaruar pakësime e shtesa kursimesh. Në dritën e këtyre provave, në kushtet kur subjekti ka qenë nën detyrimin për të deklaruar saktësisht gjendjen e fondeve të kredisë për vitet në fjalë, pretendimet e tij në procesin e rivlerësimit, janë të pabazuara. Në këtë përfundim, trupi gjykues ka parasysh edhe që saktësia e një deklarimi është në proporcion të zhdrejtë me kohën e ngjarjes – probabiliteti për pasaktësi zvogëlohet teksa periudha kohore rritet nga vitet më të hershme te vitet më të vonshme. Pavarësisht nga ky vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën financiare në skenarin e paraqitur nga subjekti për të vlerësuar pretendimet e tij në një qasje garantiste. Në përfundim, edhe sipas kësaj mënyre shpërndarjeje të të ardhurave, subjekti i rivlerësimit rezulton me bilanc negativ për të kryer shpenzimet dhe krijuar kursimet e likuiditetet me burime të ligjshme.

27.2. Në vijim edhe të arsyetimit në paragrafët e mësipërm, në kushtet kur ky shpjegim parashtrohet për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, e nuk ka asnjë gjurmë të rrethanave faktike të pretenduara nga subjekti në deklaratat e interesave privatë në vitet kur pretendohet se ka ndodhur ky veprim/mosveprim, për trupin gjykues të Kolegjit pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe të pakonfirmuara me dokumentacion në asnjë formë apo mënyrë.

- 28.** *Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka vlerësuar saktë disa zëra shpenzimesh familjare.* Konkretisht, Komisioni duhet të kishte vlerësuar ndryshe shpërndarjen e shpenzimeve për arredim në kohë, si dhe pjesën e shpenzimeve që i përkasin aktivitetit privat të bashkëshortes, lidhur me dy kreditë e marra për këtë qëllim në vitet 2006 dhe 2007 – për shkak të të cilave analiza është rënduar dy herë, duke llogaritur në shpenzime këstet e kredive dhe shpenzimet për aktivitetet sipas kontratave të kredisë. Komisioni ka gabuar me përlllogaritjen e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve për vitin 2009 dhe vitin 2014. Duhet të ishte reduktuar edhe niveli i shpenzimeve të përlllogaritura për udhëtime jashtë vendit, meqenëse kostot e udhëtimit, akomodimit dhe të qëndrimit kanë qenë më të ulëta krahasimisht me vlerat e përlllogaritura nga Komisioni. Një pjesë e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga bashkëshortja janë kryer për qëllim biznesi dhe blerje të lidhura me to, duke qenë një herë të përlllogaritura në bilancet e biznesit të saj. Subjekti ka pasqyruar në përmbajtje të ankimit, në formë narrative dhe tabelare, analizën financiare ku evidentohet vlera pozitive për çdo vit.

28.1. Për sa ka rezultuar nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me *shpërndarjen e shpenzimeve për arredim në kohë*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

- i) Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar fillimisht shpenzimet për arredim në përgjigje të pyetësorit standard, dërguar më datë 04.05.2018. Kështu, subjekti ka deklaruar se vlera e arredimit të shtëpisë “mund të ketë qenë rreth 2.000.000 lekë”, e shpenzuar gradualisht ndër vite. Më tej, në pyetjet sqaruese të pyetësorit nr. 3, për të detajuar në vite shpenzimet e arredimit, subjekti është përgjigjur se është e pamundur të specifikojë një shpërndarje të saktë të këtyre shpenzimeve për shkak të mungesës së dokumentacionit të kohës, por *rikonfirmon* vlerën totale të deklaruar në pyetësorin standard, rreth 2.000.000 lekë. I pyetur sërish në pyetësorin nr. 5, subjekti ka rikonfirmuar qëndrimin e shprehur edhe më herët se *vlera e arredimit të shtëpisë është rreth 2.000.000 lekë*, që është një shifër e përafërt, në mungesë të dokumentacionit për të evidentuar shifrat e shpenzuara ndër vite. Po në mënyrë të përafërt, subjekti shprehet se këto shpenzime *mund të kenë qenë të shpërndara rreth 480.000 lekë deri në vitin 2003, rreth 590.000 lekë në vitin 2004, rreth 580.000 lekë në vitin 2006 dhe rreth*

350.000 lekë në vitin 2007. Komisioni kreu analizën financiare ekzaktësisht sipas specifikimeve të subjektit. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, subjekti ka ndryshuar qëndrim dhe ka kërkuar që përlogaritja të ishte si vijon: përpara vitit 2003 të përlogaritej e shpenzuar vlera prej rreth 300.000 - 350.000 lekësh – përkundër 480.000 lekëve pretenduar më herët – rreth 130.000 - 180.000 lekësh gjatë vitit 2003 – dhe shpenzuar rreth 500.000 lekë gjatë vitit 2004 – përkundër 590.000 lekëve – dhe rreth 90.000 lekësh gjatë vitit 2005 – përkundër asnjë shpenzimi pretenduar më herët. Në analizën përfundimtare të pasqyruar në vendim, Komisioni ka reflektuar edhe vlerën e rishikuar të shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2003 (duke lënë vlerën 180.000 lekë), me argumentin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse. Ndërkohë që Komisioni nuk ka pranuar dhe nuk ka reflektuar në analizën financiare përfundimtare shpërndarjen e vlerës 590.000 lekë në vitet 2004 dhe 2005, përkatësisht në vlerat 500.000 lekë dhe 90.000 lekë, me argumentin se shpjegimet nuk janë në harmoni me deklaratimet e subjektit në pyetësorë dhe se vijnë për shkak të situatës financiare negative për vitin 2004.

ii) Në ankim, subjekti rivlerësimit pretendon se shpërndarja e shpenzimeve për arredim në kohë, ka qenë e përafërt. Pas analizës financiare të Komisionit, ka vlerësuar të nevojshme të saktësojë kohën kur janë kryer shpenzimet.

iii) Siç përmendet edhe më sipër, subjekti nuk ka përcjellë në Komision prova shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij për vlerat e shpenzuara dhe kohën përkatëse. Nga ana tjetër, deri në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjektet nuk kanë pasur detyrimin e deklaramit të shpenzimeve nën 500.000 lekë, përfshirë edhe ato për arredim. Për rrjedhojë, saktësia dhe konsistenca e deklarameve për këtë lloj shpenzimi mbetet e rëndësishme dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit. Në kushtet kur subjekti jo vetëm nuk ka argumentuar gjatë hetimit apo në ankim mënyrën/metodologjinë apo arsyet përse vlerat e deklaruara u ndryshuan disa herë gjatë komunikimit dhe marrjes dijeni të situatës së tij financiare nga analiza e kryer nga Komisioni, pretendimi i subjektit për “saktësimin” e këtij shpenzimi mbetet i paargumentuar bindshëm.

28.2. Lidhur me pretendimin mbi *saktësimin e pjesës së shpenzimeve që i përkasin aktivitetit privat të bashkëshortes*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

i) Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka marrë kredi bankare për aktivitetin e biznesit në emër të saj, në vitet 2006 dhe 2007, nga Fondi Besa (në vlerë 700.000 lekë), nga NBG Bank (në vlerë 250.000 lekë) dhe nga BKT (në vlerë 300.000 lekë). Në total, kreditë janë 1.250.000 lekë. Nga shkresat e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, rezulton po ashtu se bashkëshortja e subjektit, si person fizik, ka realizuar një qarkullim/të ardhura në vlerën e 991.620 lekëve, për vitin 2006. Shkresa nuk përmban të dhëna të detajuara mbi shpenzimet, fitimin dhe humbjen, ndërsa për vitin 2007 nuk ka asnjë të dhënë³¹. Nga një shkresë tjetër dërguar subjektit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, rezulton që, sipas deklaratës vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, personi fizik ka deklaruar një fitim prej 991.620 lekësh³². Sipas Bashkisë Durrës, qarkullimi vjetor i parashikuar për vitin 2007 për subjektin M. Y., ka qenë 1.000.000 lekë (data e deklaramit 28.02.2007)³³. Në përgjigjen që Bashkia Durrës i ka dhënë subjektit pak ditë më pas, në deklaratën parashikuese të qarkullimit vjetor për vitin ushtrimor 2008, subjekti M. Y. ka deklaruar një qarkullim vjetor faktik për vitin 2007, në vlerën e 1.500.000 lekëve³⁴.

³¹ Shkresat nr. {***} prot., datë 13.03.2019 dhe nr. {***} prot., datë 24.05.2018.

³² Shkresa nr. {***} prot., datë 23.05.2019.

³³ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.03.2019, drejtuar Komisionit.

³⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 13.03.2019.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kredia prej 250.000 lekësh, nga NBG-ja, marrë më datë 05.12.2006 dhe ajo prej 300.000 lekësh, nga BKT-ja, më datë 31.01.2007, janë marrë për nevoja të ushtrimit të aktivitetit (filluar më datë 06.03.2006) nga ana e bashkëshortes, meqenëse ka pasur mungesë likuiditeti për të paguar disa furnitorë apo shpenzime të ndryshme³⁵. Në përgjigje të pyetësorit 7, subjekti po ashtu ka shpjeguar se kredia prej 700.000 lekësh, e datës 23.03.2006, nga Fondi Besa, është marrë për nevoja të biznesit dhe është shpenzuar për fillimin dhe zhvillimin e aktivitetit. Sa u përket fondeve të mbetura nga kreditë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar fillimisht se pjesa e mbetur nga kreditë, nga NBG-ja dhe BKT-ja [kreditë prej 250.000 lekë dhe 300.000 lekë], pas kryerjes së shpenzimeve të biznesit, të deklaruara si më sipër, është përdorur për nevoja të biznesit dhe për nevoja familjare, pasi “aktiviteti privat i bashkëshortes si person fizik nuk është i ndarë nga individi si pjesë e familjes”, sipas tij. Subjekti ka shpjeguar më tej se mospërputhjet mes të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes, të deklaruara në deklaratat e interesave privatë periodikë, me të dhënat e administruara nga organet tatimore për shkak të deklarimit të fitimit neto përkundër atij bruto, që paraqet organi tatimor. Në përgjigje të pyetësorit 4, subjekti kërkon që të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i bashkëshortes prej 991.620 lekësh në vitin 2006, të konsiderohen fitim neto, meqenëse shpenzimet e aktivitetit për këtë vit [në vlerën 184.773 lekë] janë përfshirë në shpenzimet e përgjithshme vjetore të familjes dhe një pjesë nga kredia e marrë në NBG, shtjelluar më sipër. Në të njëjtin pyetësor [4], subjekti deklaroi se qarkullimi faktik i vitit 2007 ka qenë 1.500.000 lekë, ndërsa fitimi i realizuar ka qenë 1.250.000 lekë. Kjo e fundit është vlera e deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007 nga aktiviteti i bashkëshortes nga të ardhurat, ndërsa shpenzimet e biznesit kanë qenë 252.656 lekë.

iii) Në analizën financiare të pasqyruar në rezultatet paraprake të hetimit, Komisioni ka përfshirë në seksionin e të ardhurave qarkullimin sipas sqarimeve të subjektit – 991.620 lekë për vitin 2006 dhe 1.250.000 lekë për vitin 2007 – ndërsa në seksionin e detyrimeve janë përfshirë kreditë e sipërcituara. Në seksionin e shpenzimeve pasqyrohen shpenzime për aktivitetin sipas kontratave të kredisë (për vitin 2006 në vlerën 950.000 lekë, për vitin 2007 në vlerën 300.000 lekë) dhe shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes) si zëra më vete. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, nëpërmjet kërkesës që sipas tij përbën “saktësim”, subjekti ka kërkuar pakësimin e shpenzimeve për aktivitet duke i cilësuar ato të përfshira në kostot e biznesit, e si rrjedhojë, të përlllogaritura përpara se të deklarohen të ardhurat neto. Në vendim, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për kredinë me vlerë 700.000 lekë [nga fondi Besa], nuk janë bindëse dhe se përlllogaritja e kësaj shume në analizën e vitit 2006, si një zë shpenzimi i veçantë, paraqet situatën financiare me vërtetësi dhe saktësi. Nga ana tjetër, Komisioni konstatoi se shpjegimet e subjektit për kreditë nga NBG-ja dhe BKT-ja [me vlerë 250.000 lekë dhe 300.000 lekë], ishin bindëse. Si rrjedhojë, në analizën financiare, fitimi neto i aktivitetit privat është marrë si e ardhur dhe shpenzimet për aktivitetin që fillimisht ishin përlllogaritur sipas kontratave të kredive në fjalë, u zbritën nga analiza financiare përfundimtare, në përputhje me kërkesën e subjektit³⁶.

iv) Në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkon ndryshimin e vlerës së shpenzimeve që i përkasin aktivitetit privat të bashkëshortes – duke e cilësuar si “saktësim”. Sipas subjektit, kredia prej 700.000 lekësh, e marrë në vitin 2006, nuk duhet konsideruar shpenzim biznesi. Shuma e marrë kredi, argumenton subjekti në ankim, përfaqëson hua për nevoja të ndryshme të biznesit, por edhe nevoja të shpenzimeve familjare. Mënyra se si është përlllogaritur nga Komisioni, sipas subjektit, ka rënduar dy herë rezultatin me shpenzime: një herë në formën e

³⁵ Përgjigjet e pyetësorit 2.

³⁶ Komisioni arsyetoi se kredia prej 250.000 lekësh është përdorur për shpenzimet e aktivitetit prej 184.773 lekësh, meqenëse shumat janë aritmetikisht të përafërta. Të njëjtën qasje, bazuar në përafërsinë e shumave në diskutim, Komisioni duket se ka pranuar si “bindëse” edhe për shpenzimet e biznesit për vitin 2007. Si rrjedhojë, kredia e vitit 2006 dhe ajo e vitit 2007 nuk u përfshinë si shpenzim në analizën e secilit vit përkatësisht.

kësteve të kredisë, dhe një herë në formën e “shpenzimeve për aktivitet sipas kontratës së kredisë”. Subjekti thekson se Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimin e dhënë pas kalimit të barrës së provës për dy kreditë e tjera (nga NBG-ja dhe BKT-ja, përkatësisht në shumat 300.000 lekë dhe në shumën 250.000 lekë), ndërsa nuk ka marrë në konsideratë shpjegimin e dhënë për kredinë në shumën 700.000 lekë.

v) Pas një analize të detajuar të akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konkludon që ky pretendim është i pabazuar. Ky konkluzion bazohet së pari në konstatimin që pasqyrimi i vlerës prej 700.000 lekësh, si shpenzim për aktivitetin, nuk përkon me shpenzimin për pagesat e shlyerjes së kësteve për këtë kredi në vitet në vijim³⁷, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Këto shpenzime janë për qëllime të ndryshme dhe nuk rezultojnë të jenë i njëjti shpenzim që publikohet. Vlera prej 700.000 lekësh, e përfituar prej kredisë, është shpenzuar e gjitha për investim në biznesin e nisur në vitin 2006 nga bashkëshortja. Kjo linjë arsyetimi, përveç se merr në konsideratë faktin që kostot fillestare për fillimin e një biznesi janë kuptueshëm më të larta, përkon edhe me shpjegimet e subjektit në pyetëtorin nr. 7 [shtjelluar më sipër në paragrafin 28.2.ii]. Sikurse duket qartë, kjo vlerë aritmetikisht është shumë e ndryshme nga shpenzimi i biznesit, deklaruar për vitin 2006, në vlerën prej 184.773 lekësh. Sipas konceptit kontabël³⁸, në kushtet kur vlera e të ardhurave nga aktiviteti i biznesit në vitin 2006, bazohet në vlerën e qarkullimit [991.620 lekë³⁹] dhe jo atë të fitimit neto, në kahun e shpenzimeve duhet shtuar edhe vlera prej 184.000 lekësh, në mënyrë që të pasqyrohet saktë situata financiare neto, e prejardhur nga aktiviteti i biznesit për atë vit. Për sa i përket vitit 2007, pasqyrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve neto, kryer nga Komisioni, rezultojnë i saktë, në kushtet kur vlera prej 1.250.000 lekësh, e marrë në konsideratë, përbën fitimin neto që nënkupton se shpenzimet prej 252.656 lekësh janë zbritur një herë.

283. *Lidhur me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve*, subjekti i rivlerësimit shprehet se në analizën financiare për vitin 2009, nuk është përlogaritur një pagesë e kryer në vlerën 1.000 euro ose 137.170 lekë, ndërsa në vitin 2014, shuma e paguar ka qenë 1.500 euro ose 210.165 lekë dhe jo 288.187 lekë.

i) Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultojnë se në vitin 2014, për djalin [O. Y.], janë kryer pagesa për shkollimin në dy institucione arsimore, përkatësisht në vlerat 10.000 lekë në muaj apo 50.000 lekë në total (për periudhën janar – maj) në shkollën “{***}”⁴⁰ dhe pagesa në vlerën 1.500 euro apo 210.165 lekë, në Universitetin {***}⁴¹. Në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e shkollimit për vitin 2009, janë vendosur në vlerën 137.170 lekë, apo ekuivalenti i 1.000 eurove – sikurse pretendon subjekti – ndërsa për vitin 2014, shpenzimet janë vendosur në vlerën 260.165 lekë, sikurse konfirmohet nga aktet e administruara – dhe jo sikurse pretendon subjekti.

ii) Nga shqyrtimi i vlerave të përfshira në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë. Komisioni ka pasqyruar të dhënat e derivuara nga shkresat që kanë përcjellë

³⁷ Shpenzimet për shlyerjen e kësteve të kredisë janë evidentuar dhe faktuar nga lëvizjet e llogarive bankare, konfirmuar për Komisionin nga bankat kredidhënëse.

³⁸ Sipas bazave të kontabilitetit, fitimi neto nga një aktivitet biznesi është i barabartë me qarkullimin [të ardhurat nga xhiroja] minus kostot e aktivitetit për një periudhë kontabël të caktuar.

³⁹ Kjo vlerë nuk është fitimi neto, sikurse shprehet Komisioni, por është qarkullimi, që do të thotë se vlera e shpenzimeve prej 184.773 lekësh nuk është zbritur, prandaj duhet shtuar në kahun e shpenzimeve.

⁴⁰ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 26.03.2019, ky institucion informon se djali i subjektit ka ndjekur studimet për vitet akademike 12 shtator 2011 – 12 qershor 2012; 10 shtator 2012 – 14 qershor 2013; 16 shtator 2013 – 30 maj 2014 dhe se tarifa mujore ka qenë 10.000 lekë në muaj.

⁴¹ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 06.04.2019, për vitin akademik 2014 – 2015, janë paguar gjithsej 1.500 euro – më datë 08.10.2014 është paguar vlera 1.000 euro dhe më datë 14.10.2014 është paguar vlera 500 euro.

institucionet arsimore, përkatësisht vlerat 137.170 lekë për vitin 2009 dhe 260.165 lekë për vitin 2014.

284. *Lidhur me reduktimin e shpenzimeve të përlllogaritura për udhëtime jashtë vendit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

i) Fillimisht, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2004 – 2016, janë përlllogaritur në vlerën 7.075.996 lekë. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit pretendoi se gjatë udhëtimeve jashtë shtetit, është akomoduar te miqtë dhe të afërmit e tij, si edhe kishte shfrytëzuar ofertat e ndryshme dhe të ulëta sezonale etj. Sipas subjektit, shpenzimet për udhëtimet e kryera, kanë qenë në vlerën e përafërt rreth 5.410.040 lekë. Komisioni rishikoi analizën financiare, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për sa i përket qëndrimit të të afërmit, duke mos i përlllogaritur kosto për akomodimin. Në përfundim, vlera e shpenzimeve të udhëtimeve për periudhën 2004 – 2016, u përlllogarit në masën 6.639.882 lekë. Në ankim, subjekti i rivlerësimit argumenton se shpenzimet për akomodim dhe qëndrim kanë qenë minimale, duke ritheksuar pretendimin që kostot e qëndrimit janë përballuar nga të afërmit dhe miqtë, dhe se ka përfitur nga ofertat sezonale apo kryer prenotimet herët.

ii) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, nuk rezultojnë akte që mund të provojnë pretendimet e subjektit për kosto më të ulëta udhëtimit për shkak të ofertave sezonale⁴². Nga ana tjetër, deklaratat noteriale të të afërmit dhe miqve, të lëshuara në muajt qershor – korrik 2019 për udhëtimet e kryera nga subjekti familjarisht në ShBA, Kanada, Itali, Gjermani, Greqi, Turqi dhe Francë, nuk shoqërohen me vërtetime që provojnë vendqëndrimin e deklaruesve në periudhën kohore në fjalë, apo të dhëna për mundësitë financiare të mikpritësve për të përballuar qëndrimin e subjektit e familjes së tij në periudhat kohore në fjalë, nëpërmjet të cilave do të mund të deduktohej, qoftë edhe indirekt, gjendje financiare apo stil jetese që mundëson përballimin *tërësisht* – siç deklaruesit shprehen – apo edhe pjesërisht të shpenzimeve të akomodimit dhe të qëndrimit për subjektin dhe bashkëshorten apo gjithë familjen, përgjatë periudhës së qëndrimit. Për rrjedhojë, duke qenë të pambështetura në akte dhe dokumente provuese, pretendimet e subjektit të rivlerësimit⁴³ për reduktimin edhe më tej të shpenzimeve të udhëtimeve të subjektit, bazuar vetëm në deklaratat noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, bien ndesh me detyrimet ligjore të Kolegjit dhe Komisionit, në zbatim të neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, dhe jurisprudencën e Kolegjit⁴⁴.

285. *Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga bashkëshortja për qëllime biznesi dhe blerjeje lidhur me to, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

i) Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje, rezultojnë të administruara certifikatat e trajnimeve profesionale të marra nga bashkëshortja e subjektit. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shpenzimet për udhëtimet e kryera nga bashkëshortja për qëllime biznesi dhe *blerjeje* të lidhura me to, janë përfshirë një herë të shpenzimet e aktivitetit e, për rrjedhojë, janë zbritur nga të ardhurat e realizuara nga aktiviteti. Për rrjedhojë, ato nuk duhet të përfshihen

⁴² Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përgjigjet të datës 17.06.2019 nga agjenci të ndryshme sipas të cilave për udhëtime që janë kryer në periudha më shumë se 1 vit më parë, nuk ruhet informacion.

⁴³ Nga analiza e kryer në Kolegj, referuar të dhënave të administruara në fashikullin e Komisionit, shpenzimet e udhëtimeve rezultojnë në vlera negative më të thelluara se Komisioni [sipas përlllogaritjeve në Kolegj, totali i shpenzimeve të udhëtimeve për periudhën e rivlerësimit, është 6,758,840 lekë, ndërkohë që sipas analizës përfundimtare të Komisionit, është 6,639,882 lekë]. Metodologjia e përdorur në Kolegj është elaboruar në vendimin nr. 11/2019.

⁴⁴ Për më shumë, vendimi nr. 11/2019: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>; dhe vendimi nr. 27/2020: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi-Dritan-Peka-i-anonimizuar-per-web.pdf>

në analizën financiare, pasi bilanci financiar rëndohet dy herë për të njëjtin shpenzim. Ndër aktet e administruara, mungojnë bilancet e detajuara të aktivitetit të bashkëshortes, të cilat do të mund të vërtetonin dhe provonin vlerat e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera për qëllime biznesi apo blerjet e kryera në funksion të biznesit. Në kushtet kur subjekti ka barrën e provës⁴⁵ për të provuar edhe këtë element të pretendimeve të tij dhe nuk rezultojnë të ketë sjellë prova apo dokumente që qoftë edhe indirekt do të provonin pretendimin e tij për përfshirjen e këtyre shpenzimeve në ato të aktivitetit, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet në nivel deklarativ.

28.6. Lidhur me shqyrtimin e të dhënave të *analizës financiare* të pasqyruar në përmbajtje të ankimit në format narrativ dhe tabelar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura nga burime financiare të ligjshme shpenzimet e kryera në vitet 2004, 2006, 2008 dhe 2010 – 2015.

i) Konkretisht, duke mbajtur në konsideratë vlerësimin e kryer për shkaqet e ankimit të trajtuar në përmbajtje të këtij vendimi, në raport me pretendimet e subjektit për korrigjimin e analizës financiare për secilin vit, konstatohet se:

Për vitin 2003 – për rezultatin e pretenduar, subjekti i rivlerësimit është kontradiktor. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar një balancë pozitive prej 183.668 lekësh, ndërsa në ankim pretendon një balancë pozitive prej 533.668 lekësh. Ndërsa Komisioni ka përfshirë në analizën përfundimtare për këtë vit kursimet e pretenduara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit [në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ] prej 1.000.000 lekësh dhe kohën dhe vlerat e shpenzimeve të mobilimit, siç ka kërkuar subjekti, pretendimin se të ardhurat e babait janë përdorur në vite të tjera nuk e ka marrë në konsideratë.

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkitimi i subjektit të rivlerësimit që në analizën financiare për vitin 2003, të përlllogariten kursimet nga pensioni i të atit në vitet dhe kohën e specifikuar prej tij, nuk mbështetet në prova dhe, si i tillë, mbetet i papranueshëm. Në kushtet e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, trupi gjykues e kreu analizën duke iu përmbajtur vlerave të përlllogaritura në analizën financiare të kryer nga Komisioni⁴⁶. Pavarësisht nga kjo analizë, subjekti rezultojnë sërish me balancë negative.

Për vitin 2004 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të ndryshuar analizën financiare për sa u përket shpenzimeve të mobilimit, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, për shkak të mungesës së konsistencës së deklarimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe ndryshimeve të propozuara prej tij më shumë se një herë, e bindi trupin gjykues të Kolegjit se paraqitet për efekt të rezultatit të analizës dhe, për rrjedhojë, mbetet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative.

Për vitin 2005 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përlllogaritet të ardhura nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes së propozuar prej tij, dhe rishpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar dhe jobindëse e, për rrjedhojë, konsiderohet e papranueshme.

Për vitin 2006 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përlllogaritet të ardhura nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes së propozuar prej tij, si dhe shpenzimet për aktivitetin e bashkëshortes mbi bazën e kredisë, mbetet e paprovuar dhe nuk mbështetet në aktet e administruara gjatë procesit e, për rrjedhojë, konsiderohet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative.

⁴⁵ Neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës përcakton që: “[5.] Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”.

⁴⁶ Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit, sipas arkëtimeve të konfirmuara për secilin vit.

Për vitin 2007 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përllogaritë të ardhura nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes së propozuar prej tij, si dhe pakësimin e një pjese të fondeve të kredisë dhe shtimin e tyre në vitin 2008, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar dhe jobindëse.

Për vitin 2008 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përllogaritë të ardhura nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes së propozuar prej tij dhe përdorimin e një pjese të fondeve të kredisë apo rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve me shpenzime të reduktuara, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar dhe jobindëse, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁴⁷.

Për vitin 2009 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit që analiza financiare të përllogaritë të ardhura nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes së propozuar prej tij, për përllogaritjen e fondeve të papërdorura të kredisë, si hyrje/shtesë e të ardhurave në vitin 2010, dhe rillogaritjen e vlerave të shpenzimeve të udhëtimeve, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar dhe jobindëse.

Për vitin 2010 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të korrigjuar analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes të propozuar prej tij dhe përdorimin në vitin 2010 të një pjese të fondeve të kredisë së marrë në vitin 2009 dhe rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar dhe jobindëse, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁴⁸.

Për vitin 2011 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të korrigjuar analizën financiare, lidhur me përdorimin e të ardhurave nga pensioni i babait sipas grafikut të shpërndarjes të propozuar prej tij dhe rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar e, për rrjedhojë, konsiderohet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁴⁹.

Për vitin 2012 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të pasqyruar në analizën financiare të ardhurat në vlerën 750.000 lekë që, sipas tij, janë kontributet për shkak të ceremonisë së ndarjes nga jeta të babait dhe rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve dhe të shpenzimeve të blerjeve me kartë për qëllime biznesi, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, mbetet e paprovuar e, për rrjedhojë, konsiderohet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁵⁰.

Për vitin 2013 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të pasqyruar në analizën financiare shumën prej 500.000 lekësh nga kursimet që subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, të vëna në dispozicion të familjes, rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve dhe shpenzimeve jashtë shtetit për qëllime të biznesit, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi,

⁴⁷ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-) 440.814 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁴⁸ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-) 260.944 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁴⁹ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-) 329.795 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁵⁰ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-) 1.425.851 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

mbetet e paprovuar e, për rrjedhojë, konsiderohet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁵¹.

Për vitin 2014 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të pasqyruar në analizën financiare shumën prej 1.500.000 lekësh nga kursimet që, sipas tij, babai i tij i la përpara se të ndahej nga jeta, rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, ndryshimin e shpenzimeve të shkollimit dhe pagesave të kryera për këstet e kredisë dhe interesave përkatëse, është reflektuar pjesërisht vetëm për sa i përket përlllogaritjes së kësteve të kredisë⁵², pas verifikimit të lëvizjeve të llogarive bankare të konfirmuara nga bankat huadhënëse për Komisionin. Sipas subjektit të rivlerësimit, shuma e paguar realisht për këste kredie, është 5.856.153 lekë, ndërkohë që, sipas Komisionit, kjo vlerë është përlllogaritur 6.129.531 lekë. Nga dokumentacionit bankar i administruar në dosje, konstatohet se shumata e pagesave për këste kredie, janë në vlerën 6.021.131 lekë, e cila është e ndryshme nga vlera e përlllogaritur nga Komisioni (6.129.153 lekë), nga vlera e pretenduar në ankim nga subjekti (5.856.153 lekë) dhe nga vlera e pretenduar në parashtrimet e datës 23.07.2021 (5.961.115 lekë)⁵³. Në përfundim, pretendimet mbi kursimet që, sipas subjektit, babai i tij i la përpara se të ndahej nga jeta dhe rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, mbeten në nivel deklarativ pasi nuk konfirmohen me dokumentacion provues, çka bën që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁵⁴.

Për vitin 2015 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të reduktuar shpenzimet e udhëtimeve që pretendohet të jenë përfshirë në shpenzimet e biznesit të bashkëshortes dhe blerjet për qëllime biznesi, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, duke qenë se mbeti e paprovuar, konsiderohet e papranueshme, duke bërë që balanca financiare të mbetet në vlera negative⁵⁵.

Për vitin 2016 – kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të reduktuar shpenzimet e udhëtimeve që pretendohet të jenë përfshirë në shpenzimet e biznesit të bashkëshortes dhe blerjet për qëllime biznesi, sikurse u trajtua në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, duke qenë se mbetet e paprovuar, nuk afekton rezultatin përfundimtar për këtë vit⁵⁶.

ii) Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit sa për sipër, rezultoi se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera prej tij dhe prej personave të lidhur, për vitet 2004, 2006, 2008, 2010 – 2015. Në analizën e kryer në Kolegj, subjekti ka rezultuar me vlera negative më të thelluara se rezultati

⁵¹ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-)712.070 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁵² Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është pasqyruar në pjesën e ankimit ku trajtohet korrigjimi i analizës financiare për vitin 2014.

⁵³ Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur parashtrimeve, vërtetimin e datës 22.07.2021, lëshuar nga ABI Bank, sipas të cilit pagesat, për vitin 2014, për shlyerjen e kredisë në vlerën 15.000 euro, kanë qenë 1.375,87 euro, ndërsa për kredinë në vlerën 30.000 euro, kanë qenë 2.501,73 euro. Më datë 12.12.2014, klienti ka mbyllur detyrimet që kishte me bankën dhe totali i detyrimit të paguar për këtë vit ka qenë 40.649,92 euro.

⁵⁴ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-)2.130.815 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁵⁵ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca negative thellohet në vlerën (-)1.095.718 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

⁵⁶ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, balanca për këtë vit rezulton negative në vlerën (-) 217.302 lekë. Në kushtet e garancive procedurale për mospërkeqësim të pozitës së subjektit, vlera pozitive e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, qëndron.

financiar i Komisionit⁵⁷. Në kuadër të parimit të mospërkeqësimit të pozitive të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vlera negative prej 4.197.149 lekësh, sipas analizës së Komisionit, qëndron. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga analiza financiare e kryer në Kolegji, edhe në versionin më garantist – duke pranuar si alternativë skenarin e paraqitur nga subjekti për përdorimin e vlerave të kredisë në vitin pasardhës – subjekti i rivlerësimit rezulton me bilanc negativ për të kryer shpenzimet dhe krijuar kursimet e likuiditetet me burime të ligjshme, në totalin prej 3.759.120 lekësh.

29. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se, bazuar në provat dhe deklaratimet e paraqitura prej tij gjatë procesit administrativ, përfshirë edhe aktin e ekspertimit financiar, të ardhurat e realizuara nga ai dhe familjarët e tij mbulojnë të gjitha shpenzimet familjare, duke rezultuar me balancë pozitive në vlerën 2.199.940 lekë.*

29.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në vijim edhe të trajtimit në paragrafët e mësipërm, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë procesit të kryer në Komision, rithekson se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera prej tij dhe prej personave të lidhur me të, përgjatë periudhës 2003 – 2016, përkatësisht për vitet 2004, 2006, 2008, 2010 – 2015, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar në prova.

30. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasaktësitë apo “harresat e vogla” në deklaratat e interesave privatë periodikë nuk cenojnë situatën e përgjithshme financiare. Harresat nuk janë kryer për të fshehur pasuri dhe nuk tregojnë për mungesë të burimeve financiare. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasaktësitë rrjedhin nga mungesa e eksperiencës së nevojshme financiare për plotësimin e formularëve, pa bërë më parë një bilanc të rregullt kontabël dhe rakordim të mirëfilltë të gjendjes së parave cash. Subjekti argumenton se pasaktësitë nuk sanksionohen nga ligji nr. 9049/2003 – neni 21.*

30.1. Nga aktet e administruara në dosje, vërehet se, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Fondi Besa⁵⁸ ka informuar se, në emër të znj. M. Y., janë marrë katër (4) kredi: në datën 28.1.2004, në shumën 200.000 lekë, për blerjen e pajisjeve dhe restaurim butiku; në datën 23.03.2006, në shumën 700.000 lekë, për zgjerim biznesi; në datën 29.01.2008, në shumën 300.000 lekë, për blerje poltroni (pajisje biznesi); dhe në datën 11.06.2009, në shumën 300.000 lekë, për blerje automjeti personal.

30.2. Nga shqyrtimi i deklaratave të pasurisë për vitet 2004, 2006, 2008 dhe 2009, rezulton se personi i lidhur me subjektin – bashkëshortja – nuk ka deklaruar asnjë të dhënë lidhur me kreditë e marra pranë Fondit Besa, përkatësisht në vitet 2004 dhe 2009, ndërkohë që në deklaratat e interesave privatë për vitet 2006 dhe 2008, kreditë e marra janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

30.3. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se plotësimi me saktësi i deklaratave të interesave privatë është detyrim i subjekteve deklaruuese në zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Sipas nenit 4, shkronja “dh”, subjektet deklaruuese duhet që brenda datës 31 mars të çdo viti, të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të detyrimeve financiare, përfshirë *detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.*

⁵⁷ Kolegji konstatoi një vlerë negative në masën 7.447.504 lekë. Në kuadër të sa është shtjelluar, ndër të tjera, edhe në paragrafin 28.6, edhe në alternativën që do të pranoheshin pretendimet e subjektit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve nga të tretë, vlera negative reduktohet në masën 6.387.524 lekë.

⁵⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 03.04.2019.

30.4. Nga ana tjetër, konstatohet se pretendimet e subjektit dhe përpjekja për ta trajtuar mënyrën e deklarimit si “harresa/pakujdesi/mungesa e eksperiencës së nevojshme financiare” bien ndesh me detyrimet e tij si subjekt deklarues ndër vite, por është edhe alogjike pasi bien ndesh edhe me deklarimet e tij ndër vite, pasi dy nga katër kreditë e marra pranë Fondit Besa, përkatësisht në vitet 2006 dhe 2008 janë deklaruar rregullisht në deklaratat e interesave privatë, qasje kjo që përputhet me kërkesat ligjore, të sipërpërmendura. Megjithatë, deklarimet e pasakta dhe të paplota në deklaratat e interesave periodikë vjetorë, nuk përbëjnë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

- 31.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka arsytuar përse nuk janë konsideruar të plota shpjegimet e dhëna prej tij.* Shpjegimet i referohen realitetit ekonomik, të vërtetuara me nivelin e pasurisë familjare. Të ardhurat rrjedhin nga burime të ligjshme dhe janë lehtësisht të verifikueshme. Për përmbushjen e nevojave financiare, është marrë herë pas here kredi dhe bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve familjare është pozitiv. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë rezultatet e raportit të ILDKPKI-së dhe të ekspertit kontabël të shoqërisë audituese ndërkombëtare “{***}”, çka minimalisht duhet të kishte çelur shqyrtimin gjyqësor dhe të kishte kryer një ekspertim të pavarur.

31.1. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se çështja e analizës financiare është trajtuar në pikën 12, “Analiza financiare”, dhe është pasqyruar e plotë në rreth 10 faqe (faqet 22 – 32). Në tekst janë pasqyruar në mënyrë narrative dhe të detajuar burimet e të dhënave për nxjerrjen e të ardhurave, të detyrimeve, të shpenzimeve – sikurse shpenzimet jetike, të udhëtimit, të shkollimit, për shlyerjen e kredisë, për mobilimin, për veshje dhe produkte estetike, të telefonisë celulare, të pasurive, likuiditete (*cash*, bankë) dhe vlerat e automjeteve – si dhe janë pasqyruar në format tabelar vlerat sipas zërave të të ardhurave, detyrimeve, shpenzimeve, pasurive dhe rezultati i formulës “të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri”, për secilin vit për periudhën 2003 – 2016. Po kështu, në tekstin e vendimit është pasqyruar edhe rivlerësimi që Komisioni u ka bërë zërave të veçantë të analizës pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ. Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se për një pjesë të këtyre zërave, Komisioni është bindur nga subjekti dhe ka ndryshuar vlerat në kah pozitiv, ndërsa për një pjesë të zërave, vlerat nuk kanë ndryshuar pasi shpjegimet e subjektit u vlerësuan jobindëse, deklarative, të paprovuara dhe/ose të pajustificuara. Në dritën e sa është arsytuar edhe më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e tij apo arsytuar arsytet për këtë qasje, nuk është i bazuar.

31.2. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit se Komisioni duhet të kishte çelur shqyrtimin gjyqësor dhe të kishte kryer një ekspertim të pavarur nuk gjen mbështetje në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve të rivlerësimit dhe metodologjinë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit. Institucionet e rivlerësimit kanë tagrat ligjorë dhe janë organizuar me të gjitha kapacitetet profesionale për të vlerësuar në mënyrë të plotë dhe shteruese të dhënat nga pikëpamja financiare/ekonomike, të mbledhura gjatë procesit, duke ofruar në këtë mënyrë të gjitha garancitë e një analize objektive në funksion të procesit të rregullt⁵⁹. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në prova dhe në ligj.

⁵⁹ Sipas përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i situatës financiare dhe pretendimeve të subjekteve të rivlerësimit, kryhet nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor: “[2.] Këshilltari ekonomik ka këto detyra: a) studimi i dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit; b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes [...]”.

32. *Subjekti i rivlerësimit argumenton se ai dhe bashkëshortja disponojnë vetëm një pasuri të paluajtshme, të krijuar nga familja e origjinës dhe se gjatë hetimit administrativ, nuk është konstatuar asnjë problem lidhur me kontrollin e figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.* Pasaktësitë, apo harresat në deklaratat e interesave privatë, vijnë si rezultat edhe i rregullave jorigoroze të aplikuara nga organet e kontrollit të pasurisë gjatë kontrolleve periodike e që duhet vlerësuar në kontekst të situatës ekonomike dhe shoqërore që ka kaluar shoqëria shqiptare. Ndërgjegjësimi në mbajtjen e të dhënave për shpenzimet, ka qenë i vështirë për shkak të informalitetit të përgjithshëm për një periudhë relativisht të gjatë. Kërkesat e ligjit për deklarimin e pasurisë, kanë qenë minimale duke u shtuar e specifikuar në vijim. Nuk kërkohej të deklaroheshin shpenzimet, ndërkohë që në kuadër të procesit të rivlerësimit, kërkohen të deklarohen shpenzime të kryera përpara 20 viteve. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, shpenzimet duhet të përlogariten sipas shpjegimeve të subjektit. Subjekti i rivlerësimit parashtron se ka kryer deklarim të plotë të pasurive të familjes në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë ndër vite. Pasuritë e krijuara nga familja justifikohen plotësisht me burime të ligjshme të ardhurash. Përlogaritjet e Komisionit për shpenzimet janë të pasakta dhe rrjedhojë skemash të paaplikuara më parë. Për rrjedhojë, balancat negative duhen konsideruar nga Kolegji me proporcionalitet dhe objektivitet. Subjekti kujton që përfundimisht ka rezultuar me vlerësim pozitiv për kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional dhe se nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

32.1. Në vijim të analizës së pasqyruar në paragrafët e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti rezultoi me mungesë të konsiderueshme të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera ndër vite, në raport me të ardhurat e ligjshme të deklaruara, të verifikuara e të provuara gjatë procesit të rivlerësimit. Sikurse u trajtua gjerësisht edhe më sipër, edhe nëse abstragohet nga fakti që pretendimet për pasaktësitë në deklaratat e interesave privatë vjetorë nuk ishin bindëse, argumentet e subjektit nuk mund të përmbysin konstatimin që subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e deklaruara ndër vite. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

32.2. Nga ana tjetër, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm dhe kualifikues për sa u përket dy kriterëve të tjera – kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale – duke rezultuar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe “i aftë” profesionalisht, ky vlerësim mbetet i pavarur. Në këto kushte, vlerësimi për dy kriteret e tjera nuk afekton faktin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se çdo kriter vlerësimi ka peshën dhe rëndësinë e tij autonome. Me fjalë të tjera, pavarësisht rezultatit pozitiv në dy kriteret, nëse subjekti i rivlerësimit nuk kalon me sukses në kriterin e tretë, ndaj tij aplikohet automatikisht masa e shkarkimit nga detyra. Ky lloj prezumimi sanksionohet qartësisht në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se konfirmimi në detyrë jepet nëse plotësohen së bashku, në mënyrë kumulative, vlerësimi pozitiv për të tria kriteret: nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel i besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe në prova.

33. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, shqyrtoi provat dhe aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi nga analiza financiare për vitet 2004,

2006, 2008, 2010 – 2015, rezultoi se subjekti nuk provon aftësinë financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera në këto vite, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

34. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ndaj tij gjen zbatim masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 182, datë 18.07.2019, është i drejtë e duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 182, datë 18.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 29.07.2021.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi